



Kremtohet 97 - vjetori i Forcës Detare

Në Portin e Durrësit u zhvillua një ceremoni me rastin 97 - vjetorit të krijimit të Forcës Detare. Në ceremoni morën pjesë shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjeneral brigade Arben Kingji, komandanti i Forcës Detare, kundëradmiral Adnand Agastra, ish - komandantë të Forcës Detare ndër vite, përfaqësues të pushtetit vendor. Gjatë fjalës përshëndetëse, shefi i Shtabit të Përgjithshëm theksoi se: "Forca Detare është zhvilluar dhe modernizuar në për-

puthje me konceptin e ri të sigurisë dhe mbrojtjes së vendit, si anëtar i NATO-s dhe kandidat i BE dhe, si e tillë, ajo ka kontribute të veçanta në misionet e detyra brenda dhe jashtë vendit. Angazhimi disaveçar në misionin e NATO-s në detin Egje, gjatë të cilit janë shpëtuar mijëra jetë njerëzish, është një eksperiencë dhe një medalje nderi për Forcën Detare, një vlerë për Forcat e Armatosura dhe një krenari e dinjitet për vendin. Jo në pak raste këto detyra kanë qenë jo vetëm të

vështira, por edhe të rrezikshme. Personel nga Forca Detare shërbejnë me dinjitet dhe profesionalizëm gjithashtu edhe në struktura dhe komanda të Aleancës siç ishte dhe Operacioni "Sea Guardian" në detin Egje", - u shpreh shefi i Shtabit të FA. Gjithashtu, komandanti i Forcës Detare kundëradmiral Adnand Agastra u shpreh se: "Forca Detare si rezultat i rritjes së ndjeshme të kapaciteteve të saj operacionale, vitet e fundit ka kryer me sukses detyrat të cilat i janë... >>> faqe 5



Ceremoni festive në Ministrinë e Mbrojtjes

Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi dhe shefi i Shtabit të Përgjithshëm, gjeneral brigade Arben Kingji urojnë fëmijët e ushtarakëve



Forca Ajrore zhvillon analizën e punës vjetore

Në Garnizonin Rinas u zhvillua analiza e punës vjetore e Komandës dhe Shtabit të Forcës Ajrore, nën drejtimin e komandantit të kësaj force, gjeneral brigade Ylli Pulaj. Në këtë analizë vjetore morën pjesë edhe përfaqësues nga: Shtabi i Përgjithshëm, kolonel Aleksandër Pando, kolonel Ramadan Karakushi, drejtues të strukturave të Forcës Ajrore si dhe shefat e degëve dhe sektorëve në Shtabin dhe Komandën e Forcës. Komandanti i Forcës Ajrore, gjeneral brigade Ylli Pulaj, pasi falënderoi përfaqësuesit e SHP për mbështetjen e tyre në përmbushje...



Faqe 4

Batalioni i Xhenios i uron mirëseardhjen në atdhe Kontingjentit XI EOD

Në mjediset e Batalionit të Xhenios është zhvilluar ceremonia e ardhjes së Kontingjentit XI EOD nga Letonia. Në ceremoni mori pjesë komandanti i Komandës Mbështetëse, gjeneral brigade Ilir Xhebexhia, si dhe komandanti i Batalionit të Xhenios, kolonel Shkëlzen Mëhillaj. Kolonel Mëhillaj falënderoi gjeneralin për praninë e tij në këtë ceremoni si dhe shprehu mirënjohje për punën e bërë nga efektivitë të Kontingjentit XI. Gjeneral brigade Xhebexhia u uroi efektivave EOD mirëseardhjen...



Faqe 5

Xhubleta Shqiptare, veshja unike, tashmë pasuri e gjithë njerëzimit

Veshje tipike e grave në Shqipërinë Veriore, mbi lumin Drin, Nikaj-Mërturi e Rugova, Malësi e Madhe dhe e shqiptarëve të Malit të Zi, në zonën e Nën Shkodrës deri në Breg të Matit, ku malësorët e Malësisë së Madhe kanë zbritur. Xhubleta është një fund në trajtë kambane, që vjen i valëzuar për fundi, sidomos në pjesën e mbrapme. Përbëhej nga një numër i madh copash e rripash të ngushtë shajaku, qepur horizontalisht dhe të ndërthurur me breza gajtanësh. Mbahet e varur në supet me dy rripa të gjërë. Xhubleta shqiptare, e lashtë 4 mijë...



Faqe 11

Kremtohet 97 - vjetori i Forcës Detare

Në Portin e Durrësit u zhvillua një ceremoni me rastin 97 - vjetorit të krijimit të Forcës Detare.

Në ceremoni morën pjesë shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjeneral brigade Arben Kingji, komandanti i Forcës Detare, kundëradmiral Adnand Agastra, ish - komandantë të Forcës Detare ndër vite, përfaqësues të pushtetit vendor.

Gjatë fjalës përshëndetëse, shefi i Shtabit të Përgjithshëm theksoi se: "Forca Detare është zhvilluar dhe modernizuar në përputhje me konceptin e ri të sigurisë dhe mbrojtjes së vendit, si anëtar i NATO-s dhe kandidat i BE dhe, si e tillë, ajo ka kontribute të veçanta në misionet e detyra brenda dhe jashtë vendit.

Angazhimi disavjeçar në misionin e NATO-s në detin Egje, gjatë të cilit janë shpëtuar mijëra jetë njerëzish, është një eksperiencë dhe një medalje nderi për Forcën Detare, një vlerë për Forcat e Armatosura dhe një krenari e dinjitet për vendin. Jo në pak raste këto detyra kanë qenë jo vetëm të vështira, por edhe të rrezikshme. Personel nga Forca Detare shërbejnë me dinjitet dhe profesionalizëm gjithashtu edhe në struktura dhe komanda të Aleancës siç ishte dhe Operacioni "Sea Guardian" në detin Egje", - u shpreh shefi i Shtabit të FA.

Gjithashtu, komandanti i Forcës Detare kundëradmiral Adnand Agastra u shpreh se: "Forca Detare si rezultat i rritjes së ndjeshme të kapaciteteve të saj operacionale, vitet e fundit ka kryer me sukses detyrat të cilat i janë ngarkuar, qofshin ato kombëtare, rajonale apo

edhe në kuadër të Aleancës. Forca Detare përfaqësoi me sukses vendin tonë gjatë pjesëmarrjes me anijen e klasit 'Iliria', në aktivitetin e NATO-s në detin Egje, duke u radhitur të barabartë me kolegët e tyre të NATO.

Forca Detare gjithashtu është përfaqësuar denjësisht edhe në stërvitje rajonale në kuadër të iniciativës "Adrion", duke qenë edhe drejtuese e disa prej stërvitjeve të zhvilluara në këtë kuadër. Të gjithë këto angazhime tregojnë nivelin e lartë të profesionalizmit të personelit të Forcës Detare".



Operacion SAR nga anija P-134 "Butrinti"

Pas marrjes së informacionit nga Qendra e Vëzhgimit Detar, të cilët njoftuan për marrjen e një sinjali nga një mjet peshkimi skaf, që ndodhej në rrezik.

Mjeti tip skaf, me emër "Luna 1999", që ndodhej 8 milje në perëndim të gjirit të Dafinës, kishte pësuar defekt në motor dhe rrezikonte lundrueshmërinë dhe jetën e dy personave që ndodheshin në mjet.

Menjëherë pas njoftimit u aktivizua sistemi SAR nga anija e gatshme P - 134 "Butrinti" që ndodhej në rajon.

Si pasojë e veprimeve të sakta të efektivave të anijes së gatshme, u organizua operacioni i kërkim-shpëtimit dhe u përcaktua shpejt vendndodhja e mjetit në rrezik, duke i dhënë ndihmë në kohën e duhur.



STAFI

ANJEZA MUSOLLARI
Shefe e Sektorit të
Botimeve & Kryeredaktor

Gazetarë:
Mimoza **GOLIKJA**

Redaktore/ korrektore:
Suela **HODA**

Graphic Designer:
Afërdita **HYSAJ**

ADRESA:
Rruga e Dibrës/
Garnizoni "Skënderbej"



Ceremoni festive në Ministrinë e Mbrojtjes

Me rastin e festave të fund vitit, në mjediset e ministrisë të Mbrojtjes, u organizua ceremoni festive me fëmijë të personelit ushtarak. I pranishëm ishte ministri i Mbrojtjes z. Niko Peleshi si dhe shefi i Shtabit të Përgjithshëm, gjeneral brigade Arben Kingji.

Mes atmosferës së gëzuar, ministri Peleshi uroi fëmijët dhe prindërit e tyre për shëndet e mbarësi, duke i falënderuar për sakrificën dhe përkushtimin në këtë mision të vështirë.

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm, gjeneral brigade Arben Kingji në fjalën e tij uroi fëmijët të kenë suksese dhe të ecin në hapin e prindërve të tyre, për të bërë krenar veten dhe atdheun.

Më pas u shpërndanë dhurata për fëmijët e pranishëm dhe nën notat muzikore u mbyll ceremonia, me urimin nën një zë "Ardhtë i bardhë 2023!".



Forca Ajrore zhvillon analizën e punës vjetore

Në Garnizonin Rinas u zhvillua analiza e punës vjetore e Komandës dhe Shtabit të Forcës Ajrore, nën drejtimin e komandantit të kësaj force, gjeneral brigade Ylli Pulaj. Në këtë analizë vjetore morën pjesë edhe përfaqësues nga: Shtabi i Përgjithshëm, kolonel Aleksandër Pando, kolonel Ramadan Karakushi, drejtues të strukturave të Forcës Ajrore si dhe shefat e degëve dhe sektorëve në Shtabin dhe Komandën e Forcës.

Komandanti i Forcës Ajrore, gjeneral brigade Ylli Pulaj, pasi falënderoi përfaqësuesit e SHP për mbështetjen e tyre në përmbushje të misionit dhe prezencën në këtë analizë vjetore, ia kaloi fjalën për prezantimin e materialit të analizës shefit të Shtabit të Faj-së kolonel Genci Petanaj.

Kolonel Petanaj në prezantimin e tij evidentoi arritjet dhe objektivat e realizuara gjatë vitit 2022 si dhe punën e bërë për realizimin e këtyre detyrave si: pjesëmarrja në operacionet SAR dhe mbështetja ajrore në stërvitjet e përbashkëta në kuadër të Forcave të Armatosura, pjesëmarrja në operacionet e emergjencave civile kryesisht për shuarjen e zjarreve nga ajri, por edhe stërvitjet e tjera në interes të rritjes së kapaciteteve operacionale të strukturave të Forcës Ajrore, siç ishin Stërvitja "Biza-22" dhe "Ambicia e Shqiponjës".

Në drejtim të trajnimit të personelit, vlen për t'u përmendur programi trajnues që u finalizua pas një pune të gjatë duke licencuar 11 pilotë ushtarakë helikopteri, gjë e cila e kompletoi Bazën Ajrore Farkë me një brez të ri pilotësh, të moshës deri 25-vjeçare. Gjithashtu në Bazën Ajrore Farkë, në kuadër të bashkëpunimit dypalësh me Forcën e Sigurisë Kosovë, u krye trajnimi i 2 pilotëve kosovarë, të cilët zhvilluan një program teorik dhe një sasi të konsiderueshme orësh fluturimi me helikopterin AB-206. Në këtë panoramë të punës njëvjeçare, u përmendën gjithashtu edhe disa vështirësi të hasura sidomos në drejtim të mirëmbajtjes së mjeteve ajrore, për të cilat u diskutuan edhe opsionet më të mundshme për zgjidhjet e tyre.

Më pas u ndal tek prioritetet dhe detyrat kryesore të Forcës Ajrore për vitin e ardhshëm si: ndjekjen e punimeve vijuese në Bazën Ajrore Kuçovë, për ta shndërruar atë në Bazë Ajrore Taktike të NATO-s, ndjekja e modernizimit të teknikës ajrore, duke marrë disa helikoptere të tipit "Black Hawk" nga SHBA-të, vazhdimësinë e projektit të SIVHA, realizimin e projektit për kompletimin e Forcës Ajrore me mjetet UAV.

Në fjalën e tij, kolonel Aleksandër



Komandanti i Forcës Ajrore, gjeneral brigade Ylli Pulaj falënderoi përfaqësuesit e SHP për mbështetjen e tyre në përmbushje të misionit dhe prezencën në këtë analizë vjetore.

Pando falënderoi për prezantimin dhe stafin për punën njëvjeçare të Forcës Ajrore, duke vënë theksin se nëpërmjet

mirëkuptimit, mirë koordinimit dhe bashkëpunimit realizojmë objektivat dhe rrisim operacionalitetin e Forcës,

si dhe siguroi se, do të vazhdojë të mbështesë Forcën Ajrore në vazhdimësi për realizimin e objektivave.

Në përfundim të fjalës së tij, kolonel Pando, në emër të SHSHP, gjeneral brigade Kingji, uroi festa të gëzuara dhe shëndet të plotë, për të gjithë pjesëmarrësit dhe personelin e Forcës Ajrore. Në mbyllje të analizës, gjeneral brigade Pulaj falënderoi shefin e Shtabit të Përgjithshëm për mbështetjen që ai personalisht dhe stafi i tij i kanë dhënë Forcës Ajrore gjatë vitit 2022, duke u shprehur se sugjerimet e dala nga kjo analizë do të përkthehen në plane e programe pune për realizimin e objektivave gjatë vitit 2023.



Batalioni i Xhenios i uron mirëseardhjen në atdhe Kontingjentit XI EOD

Në mjediset e Batalionit të Xhenios është zhvilluar ceremonia e pritjes së Kontingjentit XI EOD nga Letonia.

Në ceremoni mori pjesë komandanti i Komandës Mbështetëse, gjeneral brigade Ilir Xhebexhia, si dhe komandanti i Batalionit të Xhenios, kolonel Shkëlzen Mëhillaj. Kolonel Mëhillaj falënderoi gjeneralin për praninë e tij në këtë ceremoni si dhe shprehu mirënjohje për punën e bërë nga efektivitë e Kontingjentit XI.

Gjeneral brigade Xhebexhia u uroi efektivave EOD mirëseardhjen dhe i përgëzoi ata për kontributin e çmuar të dhënë në misionin e Prezencës së Përparuar të Përforcuar (enhanced Forward Presence - eFP) të NATO-s në Letoni, si pjesë e kontributit të FA-së në përbërje të Aleancës.

Ai vuri në dukje punën, përkushtimin e profesionalizmin e treguar në realizimin me sukses të detyrës jashtë vendit si dhe i siguroi të pranishmit për mbështetjen që do të kenë nga Komanda Mbështetëse në realizimin e detyrave të ndryshme.



GJENERAL BRIGADE XHEBEXHIA U UROI EFETIVAVE EOD MIRËSEARDHJEN DHE I PËRGËZOI ATA PËR KONTRIBUTIN E ÇMUAR TË DHËNË NË MISIONIN E PREZENCËS SË PËRPARUAR TË PËRFORCUAR (ENHANCED FORWARD PRESENCE - EFP) TË NATO-S NË LETONI, SI PJESË E KONTRIBUTIT TË FA-SË NË PËRBËRJE TË ALEANCËS.

Komanda e Forcës Tokësore zhvillon analizën e punës vjetore



Komanda e Forcës Tokësore zhvilloi analizën e punës njëvjeçare, në kuadër të së cilës ishte realizimi i objektivave të vënë për vitin 2022. Mes pyetjesh dhe diskutimesh u mbyll kjo analizë, e cila nxori dhe angazhimet e kësaj force për vitin 2023.



Në zbatim të aktiviteteve dhe veprimtarive kryesore në QAPN, u zhvillua analiza vjetore me personelin e QAPN-së. I pranishëm në këtë aktivitet të rëndësishëm për punën njëvjeçare të këtij institucioni ishte komandanti i Akademisë së Forcave të Armatosura, gjeneral brigade Bilbil Bitri.

Analiza vjetore në QAPN



Studentët të Fakultetit të Mbrojtjes dhe Sigurisë kontribuojnë në vlerë monetare në disa familje në nevojë të qytetit të Vlorës

Në kuadër të festave të fundvitit, studentët dhe kadetët e Fakultetit të Mbrojtjes dhe Sigurisë kanë ndërmarrë një nismë humanitare, së bashku edhe me përfshirjen e stafit të Grupit të Komandimit, për të ndihmuar disa familje në nevojë. Fakti se për gati 2 vite FMS ka shërbyer e dislokuar në qytetin e Vlorës, ishte edhe arsyeja përse studentët zgjedhën që kontributin e tyre në vlerë monetare ta dhuronin pikërisht në disa familje në nevojë të qytetit të Vlorës, në shenjë falënderimi për mbështetjen që iu është ofruar nga vendasit. Një grup përfaqësues i trupës studentore realizoi shpërndarjen e kontributeve.





ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

"Një person lind për të lënë një shenjë të përjetshme në vetvete"

Imuniteti kulturor

Kur komunikojmë me njerëzit, ne të gjithë formojmë mendimin tonë për bashkëbiseduesin ose të njohurin. Një person na duket i bukur, një tjetër i zgjuar, i treti, i gëzuar.

Ne veçojmë tiparin kryesor në pamjen e tij dhe, mbi bazën e kësaj, nxjerrim një përfundim: ky person është i këndshëm për ne, dhe ai jo, ne duam të vazhdojmë njohjen tonë me njërin dhe përipiqemi të shmangim tjetrin.

Por nuk është vetëm bukuria e jashtme ajo që na tërheq. Gjithçka ka të bëjë me dritën e brendshme. Mbi të gjitha, nuk është sekret që shprehja e jetës shpirtërore të një personi, një pasqyrë e mendimeve, aspiratave, ndjenjave të tij, janë sytë. Bukuria e brendshme reflektohet gjithmonë në pjesën e jashtme. Dhe sa më i lartë të jetë niveli i zhvillimit mendor, moral, estetik të një personi, aq më e lartë është kultura e tij, aq më ekspresive, tërheqëse është pamja e tij dhe aq më e ndritshme është përshtypja që ai bën te të tjerët.

Prandaj kultura shpirtërore në vendin tonë pothuajse gjithmonë identifikohet me të bukurën.

Dhe kjo për faktin se një person i kulturuar është gjithmonë i vëmendshëm dhe i ndjeshëm ndaj botës që e rrethon. Zemra e tij e hapur thith gjithë të bukurën që ekziston rreth tij, dhe kjo e bukur mbush gjithë qenien e tij dhe reflektohet në pamjen e tij të jashtme. Dhe këtu çdo detaj është i rëndësishëm, çdo gjë e vogël, sepse bukuria e shpirtit fillon me gjërat e vogla. Një person që është i vëmendshëm dhe i ndjeshëm ndaj botës rreth tij është i magjepsur nga një përrua i ftohtë që murmurit nën hijen e pemëve dhe një zog i vogël që këndon këngën e tij të gëzueshme në rrezet e para të diellit pranveror dhe kërcitjen e borës së pastër të dimrit nën këmbë. Ai kurrë nuk do të zgjedhë pa mendje një lule, nuk do të lërë gjurmë barbare të qëndrimit të tij në pyll.

Ne edukojmë veten në shumë mënyra

Një person me kulturë të lartë shpirtërore përipiqet të sjellë sa më shumë përfitime. Fisnikëria e shpirtit manifestohet në lidhje me njerëzit e njohur dhe të panjohur.

Veprimet e pamatara shpesh sjellin dhimbje dhe zhgënjim, dhe, akoma më keq, të këqija dhe telashe për njerëzit e tjerë. Ndoshta, të gjithëve u ka ndodhur të shohin sesi me një fjalë njerëzit mund të lëndojnë me dhimbje, si, duke iu nënshtruar një ndjenje të menjëhershme, mund të shkatërrojnë diçka të lartë, të brishtë, të rëndësishme. Prandaj bukuria e shpirtit njerëzor qëndron, para së gjithash, në aftësinë për të kuptuar veprimet dhe dëshirat e dikujt, aftësinë për të vendosur vetë, për t'u dhënë liri ndjenjave, për të shprehur dëshirat e veta. Bukuria shpirtërore është e papajteshme me injorancën, indiferencën, dembelizmin. Ajo nuk mund të qëndrojë pranë padrejtësisë dhe të keqes. Një person i pasur shpirtërisht nuk do të



kalojë kurrë nga pikëllimi i dikujt tjetër, ai nuk do t'i lërë të dashurit, miqtë, të afërmit e tij në telashe. Duke ndjerë hollësisht bukurinë, një person i tillë gjithashtu ndjen ashpër të pavërtetën, indiferencën, mizorinë, ai është gjithmonë i shqetësuar për atë që po ndodh dhe kërkon të japë kontributin e tij të realizueshëm në përmirësimin e jetës.

Po të krahasojmë kulturën shpirtërore të shqiptarëve me atë të qytetërimeve të tjera europiane, do të konstatojmë lehtësisht se ky popull ka vlera të qëndrueshme, por edhe vlera që kanë humbur ose po tjetërsohen ditaditës, sikurse fitohen edhe të tjera, të paidentifikuara më parë.

im kulturor ?

Me një fjalë: cili jam unë?

Shqiptarët kanë qenë nga popujt e rrallë që çmonin më shumë dinjitetin e tyre se sa jetën dhe për këtë dukuri mjafton të përmendim "Kanunin e Lekë Dukagjinit". Duke u nisur nga forca që opinioni publik ka patur në të kaluarën shqiptare, por që edhe sot e kësaj dite vazhdon ta ketë, është e qartë se çdo vlerë e kësaj kulture është modeluar në mënyrë të atillë që ta "kënaqte" sa më shumë opinionin popullor dhe të bënte që të dilte sa më shumë në pah fisnikëria, bujaria, ndershmëria dhe dinjiteti i çdo shqiptari.

Në tërësi, identiteti ynë etno-kul-

ndërkohë arabët mburren se nga Libri i Shenjtë i tyre nuk lëviz asnjë shkronjë qysh prej 14 shekujsh.

Shqiptarët e kanë deri diku të zhvilluar shpirtin konkurrues, por duke e gërshetuar atë me ndershmërinë e tyre të skajshme, ata janë të destinuar ta humbasin këtë betejë. Prirjet e shqiptarëve për të ndihmuar cilindo në nevojë, edhe kur ky i fundit mund të mos ua ketë kërkuar, e vërtetojnë këtë.

Shqiptarët janë vërtet rezistentë në konkurrencë, rezistencën e kanë në gjak, por në momentin që konkurrenti tregon shenjën më të vogël të dobësisë, ata priren "t'i hapin rrugë", duke e lejuar të përfitojë nga të mirat që, sipas vlerave kulturore perëndimore, do t'u takonin me të drejta të plota atyre vetë. Gjithashtu, të bie në sy edhe fakti që shqiptarët konkurrojnë deri në momentin që fitojnë dhe pastaj ia lënë në dorë fatit të veprojë.

Në marrëdhëniet e ndryshme mes njerëzve, lindja e konflikteve është diçka e zakonshme.

Në zgjidhjen e tyre ndikon drejtpërdrejt vlera kulturore e bujarisë, e cila tek shqiptarët është një nga profilet më të spikatura të formimit të tyre psiko-kulturor; ajo shfaqet kudo dhe ndaj cilitdo, pavarësisht nëse ky i fundit është në nevojë apo jo.

Shqiptarët mendojnë se nëpërmjet bujarisë lartësojnë dinjitetin e tyre vetjak dhe këtu qëndron edhe një paradoks tjetër, pasi ata kanë sakrifikuar historikisht deri edhe jetën e tyre për të ngritur lart dinjitetin.

Në shoqëritë moderne, puna është burimi kryesor i të ardhurave dhe, pikërisht nëpërmjet punës, del në pah korrektësia e dikujt.

Natyrshtëm lind pyetja: a janë shqiptarët korrektë në punë?

Për t'i dhënë përgjigje kësaj pyetjeje, mjafton të sakrifikojmë një mëngjes të hënë dhe të sillemi nëpër kafenetë e Tiranës. Pamja që do shfaqet është e thjeshtë: ato do jenë aq të mbushura, sikur të ishte

një e shtunë pasdite. Por kjo ende nuk do të thotë se shqiptarët nuk janë korrektë. Në marrëdhëniet me njëri-tjetrin dhe, sidomos me të huajt, korrektësia e tyre i kalon kufijtë e të zakonshmes.

Shqiptarët janë korrektë, por nuk dinë ku dhe kur ta shfaqin korrektësinë.

Zgjidhja e këtij problemi do të ishte mjaft e thjeshtë, nëse shqiptarët do mësonin të zbatonin këtë vlerë kulturore sipas kërkesave të kohës.

Sidoqoftë, përtej këtyre "handikapëve" kulturore, ne shqiptarët duhet të ndihemi realistë, krenarë dhe optimistë: realistë sepse këto kanë qenë mundësitë e një populli të vogël, si i yni; duhet të ndihemi krenarë sepse pavarësisht pushimeve, shqiptarët ekzistojnë, kultura e tyre është pjesë krejt e veçantë e mozaikut të kulturave botërore; dhe në fund do të ndihemi optimistë, nëse nuk do ketë më imponime kulturash.

Të rinjtë e epokës digjitale drejt humnerës kulture, apo përplasje ndasish mes brezash?!

Sot një brez i tërë i epokës dixhitale, ka arritur në moshë madhore në një botë në të cilën e kaluara nuk është më e kaluara në kuptimin që ne jemi mësuar ta kuptojmë dikur. Sot asgjë nuk harrohet. Pothuajse gjithçka që keni përjetuar, çdo veprim që keni ndërmarrë, është një kronikë e pashmangshme diku në rrjet. Kujtesa nuk mund t'ju bëjë ta modifikoni të kaluarën tuaj me disa kujtime rozë. Ju nuk mundeni ta romantizoni, apo ritregoni historinë tuaj. E shumta që mund të bëni është ta ripërzieni lëndën e parë me një ambalazh nga e tashmja.

Kjo do të thotë, se njerëzit që hyjnë sot në jetën publike, ka të ngjarë të bëhen gjithnjë e më të çuditshëm.

"Padija rinore", ajo që të përball me drogën në të 20-at e hershme, zgjedhja e sikletshme e një fustani shumë ekstravagant, një moment i një gjesti seksual për të cilin mund të mos e vrasësh mendjen, nuk është më diçka që mund të harrohet apo të lihet në heshtje...

Kjo pasi provat do të jenë ende atje, diku, në ndonjë video të mallkuar në TikTok, apo në ndonjë arkiv në Instagram gjatë gjithë kohës. Ju mund të mendoni që ne mund ta rregullojmë disi moralin tonë publik për të qenë më falës. Por nuk duket se është ky drejtimi në të cilin po lëviz kultura.

Përkundrazi, ne jemi më të prirur se kurrë të abuzojmë me historinë tonë kolektive dhe personale. Prandaj, ka shumë të ngjarë që të vetmit njerëz që do t'i mbijetojnë shqyrtimit të hollësishëm si kandidatë, do të jenë ata që duke qenë të vendosur të mos kenë asnjë karrierë në jetën publike që në fillimet e adoleshencës së tyre, patën një vigjilencë mbinjerëzore për t'u siguruar që të mos bëjnë asnjëherë ndonjë gjë, për të cilën më vonë mund të ndihen të turpëruar.

Në fakt kultura është përsheptuar tani. Dhe unë dyshoj se një nga problemet më të thella për një brez që shqyrton kujtimet që krijoi vetëm disa vjet më parë, dhe mediat "e vjetra" që i krijonin ato, do të jetë se si të negociohet me atë lloj kujtesë të përsheptuar, me atë lloj nostalgjie të menjëhershme, gjatë një jete të gjatë.



Kultura, identitet personal, social apo entitet kombëtar?

Kultura shqiptare nuk ofron ende një "filtër" të mirëfilltë ndarës mes kulturës perëndimore dhe asaj lindore.

Ndonëse shqiptarët janë zgjuar nga "gjumi letargjik" gjatë këtyre viteve të tranzicionit, ata nuk janë çliruar ende plotësisht nga "hipnoza" 50-vjeçare. Realiteti shqiptar ka një nevojë të domosdoshme të përballojë të vërtetën.

Është bërë e shpeshtë biseda lidhur me atë se çfarë modeli kulturor ndjek përgjithësisht shqiptari. Me një fjalë, nëse modeli i sjelljes dhe i përfytyrimit që ai ka për botën është perëndimor apo edhe perëndimor edhe "ndryshe".

Herë pas here, sipas rastit, ndodh që njeriu të pyesë veten: cili është modeli

turor është formësuar falë principeve oksidentale.

Unë mendoj se kultura shqiptare nuk ofron ende një "filtër" të mirëfilltë ndarës mes kulturës lindore kundrejt asaj perëndimore. Është e vërtetë se ne shqiptarët kemi gjuhë dhe tradita unike.

Por, a ka vërtet diçka për t'u "mburrur" në këtë pjesë? Çdo popull ka traditat e tij të veçanta në folklor apo në kostumografi, ndryshe nga popujt e tjerë.

Gjuha jonë vërtet është një degë krejt e veçantë, por ajo shfaqet e dokumentuar vetëm në shekujt XIV-XV, ndërkohë që një shekull më vonë anglishtja e Shekspirit mahnit ende sot gjithë botën. Ne kemi vetëm një shekull e gjysmë që përdorim alfabetin tonë, kur

VJTF, REAGUESI I PARË I ALEANCËS

Përshtati: MIMOZA GOLIKJA

Gjermania merr drejtimin për Forcën e Gatishmërisë së Lartë të NATO-s

Të dielën e 1 janarit të vitit 2023, Gjermania do të marrë drejtimin e forcës ushtarake të gatishmërisë së lartë të NATO-s, duke vendosur mijëra trupa në gatishmëri, dhe të gatshme për t'u vendosur brenda disa ditësh ku të jetë nevoja. Task Forca e Përbashkët e Gatishmërisë Shumë të Lartë të NATO-s (VJTF) u krijua në vitin 2014, në thelb të një Force Reaguese të përforuar të NATO-s, pas aneksimit të paligjshëm të Krimesë nga Rusia dhe krizave në Lindjen e Mesme. Gjermania merr drejtimin nga Franca, e cila udhëhoqi forcën në vitin 2022. Në përgjigje të pushtimit të Ukrainës nga Rusia në shkurt të këtij viti, NATO dislokoi elementë të VJTF në Rumani në misionin e parë të njësisë për mbrojtjen kolektive. "Gjermania është një aleate e rëndësishme dhe ne falënderojmë atë për udhëheqjen e VJTF në vitin 2023", - tha zëdhënësjja e NATO-s Oana Lungescu. "Ndërsa lufta e paligjshme e Rusisë në Ukrainë vazhdon të kërcënojë paqen dhe sigurinë në Evropë, nuk duhet të ketë asnjë dyshim për vendosmërinë e NATO-s për të siguruar dhe mbrojtur çdo centimetër të territorit aleat. VJTF është reaguesi i parë i NATO-s dhe një pjesë kyçe e mbrojtjes sonë kolektive. Udhëheqja e Gjermanisë është një shfaqje e fortë e angazhimit dhe aftësive të saj", - tha znj. Lungescu.

VJTF është elementi i gatishmërisë së lartë të Forcës së Reagimit të NATO-s. Udhëheqja dhe anëtarësimi i VJTF drejtohet me rrotacion çdo vit midis aleatëve. Në vitin 2023, forcat tokësore të VJTF do të përbëhen nga rreth 11 500 mijë trupa, me brigadën "Panzer Grenadier" 37 në thelbin e saj. Në total, nëntë aleatë të NATO-s (Belgjika, Çekia, Letonia, Lituania, Luksemburgu, Gjermania, Holanda, Norvegjia, Sllovenia) do të kontribuojnë në të. Ndër njësitë kryesore janë Panzerbataillon 393 i Gjermanisë, (batalion tankesh); Artillerielehrbataillon 345, (Batalioni i Stërvitjes së Artilerisë); Versoningsbataillon 131, (Batalioni i furnizimit) dhe Transporthschrauberregiment 30 (Regjimenti i helikopterëve të transportit). Për herë të parë, Gjermania drejton gjithashtu komandën e Forcave Speciale të përcaktuara nga VJTF.

Plani i Veprimit të Gatishmërisë, bazë e qëndrimit parandalues dhe mbrojtjes i Aleancës

Plani i Veprimit të Gatishmërisë është një paketë gjithëpërfshirëse e masave të sigurimit dhe përshtatjes që janë pjesë e bazës së qëndrimit parandalues dhe mbrojtjes të Aleancës. I rënë dakord në Samitin e Uellsit të vitit 2014, Plani i Veprimit të Gatishmërisë (RAP) ishte një shtytës thelbësor i përshtatjes ushtarake të NATO-s me mjedisin në zhvillim të sigurisë dhe filloi përforçimin më të rëndësishëm të mbrojtjes kolektive të NATO-s që nga fundi i Luftës së Ftohtë. Në Samitin e Varshavës 2016, udhëheqësit e vendeve anëtare përshëndetën zbatimin e tij dhe ranë dakord për masa shtesë për të forcuar parandalimin dhe qëndrimin mbrojtës të NATO-s.

Masat e sigurimit janë një seri aktivitesh tokësore, detare dhe ajrore në, mbi dhe rreth territorit të aleatëve të NATO-s, në Evropën Qendrore dhe Lindore, të dizajnuara për të përforcuar mbrojtjen e tyre, për të siguruar popullsinë e tyre dhe për të penguar agresionin e mundshëm. Këto masa janë rezultat i drejtpërdrejtë i aneksimit ilegal dhe të paligjshëm të Krimesë të Ukrainës nga Rusia. Ato përfshijnë një prani ushtarake në lindje të Aleancës dhe të gjithë aleatët e NATO-s po kontribuojnë në këto masa



në bazë të rrotacionit. Masat mund të rriten ose zvogëlohen sipas nevojës, në varësi të situatës së sigurisë dhe që nga maji 2014, NATO ka rritur numrin e avionëve luftarakë në patrullimet e policisë ajrore mbi shtetet baltike dhe ka vendosur avionë luftarakë në Bullgari, Rumani dhe Poloni. Në dhjetor 2015, u ra dakord për një paketë të mëtejshme masash sigurie të përshatura për Turqinë. Aleanca kryen fluturime të rregullta vëzhgimi AWACS mbi territorin e aleatëve të saj lindorë dhe fluturime të avionëve të patrullimit detar përgjatë kufijve lindorë të territorit aleat.

Për të ofruar siguri në det, NATO vendos një numër forcash detare shumëkombëshe si dy Grupe të Përherëshme Kundërmasash të Minave të NATO-s që patrullojnë Detin Baltik dhe Mesdheun Lindor, dhe një Grup Detar të zgjeruar të NATO-s që kryen masa sigurimi detar përveç patrullimeve kundër terrorizmit. NATO ka rritur gjithashtu numrin e stërvitjeve që organizon. Stërvitjet ushtarake ofrojnë mundësi të rëndësishme për të përmirësuar aftësinë e aleatëve dhe partnerëve për të punuar së bashku dhe janë një demonstrim i vlefshëm i gatishmërisë së NATO-s për t'iu përgjigjur kërcënimeve të mundshme. Këto ushtrime zhvillohen në tokë, në det, në ajër dhe në hapësirën kibernetike me skenarë të bazuar në mbrojtjen kolektive dhe menaxhimin e krizave. Masat e sigurimit janë fleksibël dhe të shkallëzuar në përgjigje të situatës në zhvillim të sigurisë dhe mbahen nën shqyrtim vjetor nga Këshilli i Atlantikut të Veriut, organi kryesor vendimmarrës politik i NATO-s.

Masat e përshtatjes janë ndryshime afatgjata në forcat dhe strukturën komanduese të NATO-s, të cilat do ta bëjnë Aleancën më të aftë për të reaguar me shpejtësi dhe vendosmëri ndaj krizave të papritura. Këto përfshijnë Forcën e Reagimit të NATO-s (NRF), që është një forcë shumëkombëshe shumë e gatshme dhe e avancuar teknologjikisht, e përbërë nga komponentë tokësorë, ajrorë, detarë dhe të Forcave të Operacioneve Speciale (SOF), që Aleanca mund t'i vendosë shpejt, kudo që të jetë e nevojshme. Në Samitin e Uellsit të vitit 2014, aleatët vendosën të përmirësojnë NRF-në për të forcuar mbrojtjen kolektive të Aleancës dhe për të siguruar që NATO të ketë forcat e duhura në vendin e duhur në kohën e duhur. NRF përbëhet nga rreth 40 000 personel, një rritje e madhe nga niveli i mëparshëm prej 13 000. Madhësia e saj varet nga detyra për të cilën nevojitet. Komandanti

Suprem i Aleatëve në Evropë (SACEUR) ka komandën e përgjithshme të NRF-së. Çdo vit me rrotacion, dy Komandat e Forcave të Përbashkëta të NATO-s (me bazë në Brunssum, Holandë dhe Napoli, Itali) kanë komandën operacionale të NRF-së. Kurse Task Forca e Përbashkët e Gatishmërisë Shumë të Lartë (VJTF), brenda NRF, është një "forcë majë shtize" prej rreth 20 000 trupash, nga të cilat rreth 5 000 janë forca tokësore, është në gjendje të fillojë vendosjen brenda dy deri në tre ditë, kudo që të jetë e nevojshme. Elementi tokësor VJTF mbështetet nga komponentët ajror, detar dhe SOF. Udhëheqja dhe anëtarësimi i VJTF dhe NRF rrotullohen midis aleatëve në baza vjetore. Forcat e VJTF dhe NRF janë të vendosura në vendet kryesore, por janë në gjendje të vendosen kudo që nevojiten për stërvitje, reagim ndaj krizave ose mbrojtje kolektive. VJTF, e cila mori pjesë në stërvitjen e saj të parë të vendosjes në Poloni në qershor 2015, testohet rregullisht gjatë stërvitjeve.

Ndërsa Njësitë e Integritit të Forcave të NATO-s (NFIU) janë shtabë të vogla shumëkombëshe që lehtësojnë vendosjen e shpejtë të VJTF-së dhe forcave aleate pasuese. Secili prej tyre përbëhet nga rreth 40 specialistë kombëtarë dhe të NATO-s. Detyra e tyre është të përmirësojnë bashkëpunimin dhe koordinimin ndërmjet NATO-s dhe forcave kombëtare, si dhe të përgatisin dhe mbështesin stërvitjet dhe çdo vendosje të nevojshme. Si fillim, gjashtë NFIU u krijuan në Bullgari, Estoni, Letoni, Lituani, Poloni dhe Rumani dhe u inauguruan në shtator 2015, duke përbërë një prani të dukshme dhe të vazhdueshme të NATO-s në këto vende. Më pas, dy NFIU të tjera në Hungari dhe Sllovakia u inauguruan, përkatesisht, në shtator 2016 dhe janar 2017.

Shtabi i Korpusit Shumëkombësh Verilindor (HQ MNC-NE), në Szczecin, Poloni ofron një aftësi të gatishmërisë së lartë për të komanduar forcat e dislokuara në Shtetet Baltike dhe Poloni, nëse kërkohet. I themeluar nga Danimarka, Gjermania dhe Polonia, HQ MNC-NE ka katër detyra kryesore si komandimi i VJTF-së dhe NRF-së, ose elementeve të tyre, nëse dislokohen në rajonin verilindor të NATO-s; ushtrimin e kontrollit operacionel mbi NFIU-të në Estoni, Hungari, Letoni, Lituani, Poloni dhe Sllovakia; monitorimin e situatës së sigurisë në rajon; dhe duke vepruar si një qendër rajonale për bashkëpunim. Shtabi i Divizionit Shumëkombësh Juglindor (HQ MND-SE) në Bukuresht, Rumani

është në gjendje të komandojë forcat e dislokuara brenda rajonit juglindor të NATO-s, duke përfshirë VJTF dhe NRF, nëse është e nevojshme. Ai ekzekuton komandën dhe kontrollin mbi NFIU-të në Bullgari dhe Rumani. Ai gjithashtu monitoron situatën e sigurisë në rajon dhe vepron si një qendër për bashkëpunimin rajonal midis aleatëve. HQ MND-SE u inaugurua më 1 dhjetor 2015 dhe arriti aftësinë përfundimtare operacionale më 22 mars 2018. Përveç kësaj, RAP kërkon "një numër përmirësimesh logjistike", duke përfshirë paracaktimin e pajisjeve dhe furnizimeve, për të rritur gatishmërinë e NATO-s për t'iu përgjigjur çdo sfide ndaj sigurisë së Aleatëve. Brenda Strukturës së Komandës së NATO-s u krijua një seli e re e grupit të përbashkët të mbështetjes logjistike.

Përgjigje e sfidave të reja të sigurisë

Në shtator 2014, në Samitin e NATO-s, në Uells, aleatët miratuan Planin e Veprimit të Gatishmërisë për të siguruar që Aleanca të jetë gati për t'iu përgjigjur me shpejtësi dhe vendosmëri sfidave të reja të sigurisë. Plani ofron një paketë gjithëpërfshirëse masash për t'iu përgjigjur ndryshimeve në mjedisin e sigurisë në dhe afër Evropës dhe ndaj kërcënimeve që vijnë nga Lindja e Mesme dhe Afrika e Veriut. Kurse më 5 shkurt 2015, ministrat e Mbrojtjes të NATO-s vendosën që VJTF do të përbëhej nga një komponent tokësor prej rreth 5 000 trupash me njësi të përshatshme ajrore, detare dhe SOF në dispozicion. Franca, Gjermania, Italia, Polonia, Spanja, Turqia dhe Mbretëria e Bashkuar ranë dakord të marrin rolet kryesore për VJTF-në me rrotacion në vitet e ardhshme. Ministrat vendosën gjithashtu synimin për të pasur një VJTF të aftë operacionalisht deri në Samitin e Varshavës 2016, një synim që u arrit. Kurse në prill 2015, më shumë se 1 500 trupa morën pjesë në stërvitjen Noble Jump, e krijuar për të testuar nëse trupat e caktuar në VJTF të Përkohshme të NATO-s mund të ishin gati për t'u vendosur 48 orë pas marrjes së një urdhri për lëvizje. Ndërsa më 9 qershor 2015, VJTF u vendos për herë të parë në Poloni gjatë stërvitjes Noble Jump, ku morën pjesë mbi 2 100 trupa nga nëntë vende të NATO-s dhe më 24 qershor 2015, ministrat e Mbrojtjes të NATO-s morën vendime për komponentët ajrorë, detarë dhe SOF të NRF-së së zgjeruar, duke rënë dakord që ajo mund të përbëhet nga deri në 40 000 personel. Gjithashtu u morën më tej masa për të përshpejtuar vendimarrjen politike dhe ushtarake, duke përfshirë autoritetin për Komandantin Suprem të Aleatëve të NATO-s në Evropë për të përgatitur trupat për veprimin sapo të merret një vendim politik. Aleatët miratuan gjithashtu një mjet të ri planifikimi paraprak, "Graduated Response Plans", duke mundësuar që planet e operacioneve të ekzekutueshme të gjenerohen jashtëzakonisht shpejt, në përpjesëtim me kërkesat e gatishmërisë së forcave. Aleatët ranë dakord gjithashtu për krijimin e një shtabi të ri të grupit të përbashkët të mbështetjes logjistike brenda Strukturës së Komandës së NATO-s. Më në fund, ministrat e Mbrojtjes ranë dakord që në tetor do të vendosnin për ngritjen e selisë së re të NFIU-së, përveç gjashtë selive ekzistuese shumëkombëshe të NFIU-së. Në shtator 2015, NFIU-të u

inauguruan në Bullgari, Estoni, Letoni, Lituani, Poloni dhe Rumani dhe në tetor 2015, ministrat e Mbrojtjes të NATO-s i dhanë dritën jeshile konceptit të plotë ushtarak për NRF-në e zgjeruar, duke përfshirë rregullimet e komandës dhe kontrollit të saj. Ata ranë dakord gjithashtu për të krijuar dy NFIU të tjera në Hungari dhe Sllovakia. Kurse në dhjetor 2015, NATO përuroi Shtabin e Divizionit Shumëkombësh Juglindor në Bukuresht, duke shënuar integrimin e saj zyrtar në Strukturën e Komandës së NATO-s. Shtabi i ri me gatishmëri të lartë është në gjendje të komandojë forcat e dislokuara brenda rajonit juglindor të NATO-s, duke mbështetur mbrojtjen e Aleancës. Është gjithashtu një qendër për bashkëpunimin rajonal midis aleatëve. Në korrik 2016, në Samitin e Varshavës, aleatët mirëpritën zbatimin e Planit të Veprimit të Gatishmërisë, pohuan se masat e tij të sigurimit dhe përshtatjes do të vazhdonin të formonin bazën e qëndrimit parandalues dhe mbrojtës të Aleancës, dhe ranë dakord ta forcojnë më tej këtë qëndrim. RAP i ofron Aleancës një gamë të gjerë opsionesh për të qenë në gjendje t'i përgjigjet çdo kërcënimi nga kudo që ato lindin për të mbrojtur territorin e Aleancës, popullsinë, hapësirën ajrore dhe linjat detare të komunikimit. Dy NFIU-të e fundit në Hungari dhe Sllovakia u inauguruan, përkatesisht, më 18 nëntor 2016 dhe 24 janar 2017.

Në Samitin e Brukselit 2018, udhëheqësit e NATO-s përsëritën vendosmërinë e tyre për të forcuar gatishmërinë, reagimin dhe përforçimin e Aleancës për t'iu përgjigjur kërcënimeve nga çdo drejtim në një qasje 360 gradë. Nisma e Gatishmërisë së NATO-s, u fillua për të rritur aftësinë e Aleancës për reagim të shpejtë, qoftë për përforçimin e aleatëve në mbështetje të parandalimit ose të mbrojtjes kolektive, duke përfshirë luftime me intensitet të lartë, ose për ndërhyrje të shpejtë në krizë ushtarake, nëse kërkohet. Që atëherë, aleatët janë zotuar të ofrojnë 30 batalione të mekanizuara, 30 skuadronë ajrore dhe 30 luftanije të gatshme për t'u përdorur brenda 30 ditëve ose më pak dhe po punojnë për të ndërtuar dhe ruajtur nivelin e gatishmërisë së katyre forcave dhe për t'iu organizuar ato në formacione më të mëdha. Në Samitin e Brukselit të vitit 2021, aleatët përshëndetën përparimin e rëndësishëm të bërë në zbatimin e vendimeve të tyre të mëparshme për të forcuar qëndrimin parandalues dhe mbrojtës të NATO-s dhe riafirmuan angazhimin e tyre për zbatimin e plotë dhe të shpejtë të këtyre vendimeve.

Pas pushtimit brutal dhe të paprovokuar të Rusisë në shkallë të gjerë të Ukrainës në vitin 2022, aleatët morën hapa të mëtejshëm për të forcuar qëndrimin parandalues dhe mbrojtës të NATO-s, duke përfshirë vendet anëtare të NATO-s në lindje të Aleancës. Këto hapa kanë përfshirë aktivizimin e planeve të mbrojtjes të NATO-s, vendosjen e elementeve të NRF-së, krijimin e grupeve luftarake shumëkombëshe shtesë dhe vendosjen e 40 000 trupave në krahun lindor të Aleancës, së bashku me asetet e rëndësishme ajrore dhe detare, nën komandën e drejtpërdrejtë të NATO-s të mbështetur nga dislokimet kombëtare të aleatëve. Këto masa, të cilat mbeten parandaluese, proporcionale dhe joshkallëzuese, sigurojnë sigurinë dhe mbrojtjen e të gjithë aleatëve në të gjitha fushat dhe me një qasje 360 gradë.

Aleatët të përkushtuar për lirinë dhe sigurinë e njëri-tjetrit

Parandalimi dhe mbrojtja, detyra kryesore e NATO-s

Viti 2022 që po lemë pas shënoi gjithashtu edhe 70-vjetorin e “ish-Letrave të NATO-s”, që janë opinione dhe analiza ekspertësh mbi një gamë të gjerë çështjesh të sigurisë euroatlantike që janë ofruar gjatë shtatë dekadave të fundit. Këto materiale të botuara që marrin formën e dokumenteve, ndonjëherë kanë qenë reflektues, ndonjëherë parashikues, por gjithmonë në vijën e parë të debatit. Këto opinione dhe analiza cilësohen një trashëgimi e rëndësishme në historinë e opinion-bërjes të Aleancës dhe duke u kthyer kokën pas edhe njëherë na jepet mundësia të reflektojmë se si Aleanca politike dhe ushtarake, NATO, ka evoluar gjatë dekadave. Por ajo që vërehet tek të gjitha është se theksohet themeli i fortë i NATO-s që nuk ka ndryshuar, lidhja transatlantike në zemër të Aleancës, uniteti i saj, pavarësisht dallimeve të aleatëve dhe betimi solemn për të mbrojtur njëri-tjetrin kundër çdo kërcënimi.

Opinion i fundit i ribotuar për vitin 2022, si pjesë e Rishikimit të 70 viteve të analizave të NATO-s është ai i autorit konsistent dhe afatgjatë të opinion-bërjes në NATO, Michael Rühle, në prill 2015. Nganjëherë ky vit mund të duket i largët, por parë nën dritën e ngjarjeve aktuale e ri sjellë sot është dëshmi se sa ka ndryshuar në rreth tetë vitet e fundit situata. Ndërsa në vitet 2000 dhe në fillim të viteve 2010, parandalimi ishte bërë një koncept i fjetur, pasi u la mënjanë në fund të Luftës së Ftohtë për të krijuar hapësirë për përbalimin e sfidave të reja dhe zgjerimin e Aleancës. Por në vitin 2014, pas aneksimit të paligjshëm të Krimesë nga Rusia, parandalimi ishte bërë një vend në qendër të skenës së përditshmërisë si një nga detyrat kryesore tradicionale të NATO-s dhe shtylla kurrizore e nenit 5. Agresioni rus në Ukrainë theksoi domosdoshmërinë e sigurimit të parandalimit dhe qëndrimit mbrojtës të NATO-s ishte dhe do të mbetej i besueshëm dhe efektiv.

Parandalimi: Çfarë mund (dhe nuk mund) të bëjë NATO

Parandalimi po kthehet. E perceptuar nga shumë njerëz si një relike e thjeshtë e Luftës së Ftohtë, kriza Rusi-Ukrainë e ka përshpejtuar ringjalljen e saj. Megjithatë, debati gjatë muajve të fundit mbi mënyrën më të mirë për të frenuar Rusinë zbulon se 20 vjet neglizhencë kanë bërë të vetën. Pjesa më e madhe e asaj që dikur konsiderohej njohuri bazë mbi parandalimin duket se ka ‘avulluar’. Atëherë, çfarë është parandalimi? Çfarë mund të arrijë - dhe çfarë jo? Parandalimi është kërcënimi i forcës për të deklaruar një kundërshtar nga ndërmarrja e një veprimi të padëshiruar. Kjo mund të arrihet përmes kërcënimit të hakmarrjes (parandalimi me dënim) ose duke mohuar qëllimet e luftës së kundërshtarit (frenimi me mohim). Ky përkufizim i thjeshtë shpesh çon në përkufizimin se gjithçka që duhet për të penguar është të vendosësh forcë të mjaftueshme në shfaqje. Për sa kohë që të dyja palët veprojnë “rationalisht”, d.m.th. sipas një llogaritjeje kosto-përfitim, dhe nëse asnjëra prej tyre nuk është vetëvrasëse, potencialet e tyre ushtarake do ta mbanin njëri-tjetrin në kontroll.

Sikur të ishte kaq e lehtë. Historia është e mbushur me shembuj të dështimit të parandalimit pavarësisht një ekuilibri forcash, madje edhe raste kur pala më e dobët sulmonte më të fortën. Në disa raste, pala e dobët mbështeti elementin e befasisë. Udhëheqja ushtarake e Japonisë Perandorake, për shembull, ishte plotësisht e vetëdijshme për epërsinë ushtarake të SHBA-së. Por nëse një sulm i befasisëm në bazën detare “Pearl Harbor” do të shkatërronte një pjesë të madhe të Flotës së Paqësorit të SHBA-së, ndërkohë që do të paralizonte politikisht Uashingtonin, Japonia mund të kishte një shans për të



mbizotëruar. Në vitin 1973 Siria dhe Egjipti sulmuan Izraelin superior ushtarak, jo sepse shpresonin të fitonin, por sepse donin të rivendosnin fuqinë politike që kishin humbur pasi Izraeli i kishte mundur ata në Luftën Gjashtë Ditore të 1967-ës. Izraeli nuk e kishte parë sulmin që po vinte: pse dy vende ushtarakisht inferiore madje do të mendonin të sulmonin një kundërshtar që ishte i sigurt se do të dilte fitimtar? Kjo siguri në vetvete bëri që Izraeli të shpërfillte sinjalet e shumta paralajmëruese për një sulm në pritje. Si rezultat, ushtritë e Egjiptit dhe Sirisë që përparonin me shpejtësi ishin fillimisht shumë më të suksesshme sesa pritej. Epërsia ushtarake nuk kishte siguruar frenim. Një shembull tjetër i rëndësishëm për grackat e parandalimit është dhënë nga Lufta e Falklands e vitit 1982. Argjentina, e cila konteston autoritetin e Mbretërisë së Bashkuar mbi ishujt në Atlantikun e Jugut, e dinte shumë mirë epërsinë e forcave të armatosura britanike. Megjithatë, gjatë disa dekadave, Britania e Madhe kishte reduktuar gradualisht mbrojtjen e saj ushtarake për ishujt. Kështu, ndërsa Londra vazhdoi të theksonte se Falklandët ishin britanikë, junta ushtarake në Buenos Aires u bind se deklarata të tilla ishin thjesht fjalë. Kur Junta u përball me një krizë të brendshme që kërcënonte sundimin e saj, ajo u përpoq të gjeneronte mbështetje duke nxitur ndjenjat patriotike dhe pushtoi ishujt. Parandalimi kishte dështuar sepse Mbretëria e Bashkuar kishte injoruar një faktor të rëndësishëm. Marrja e një poze të ashpër, ndërsa në të njëjtën kohë zvogëlon mjetet për t'i bërë mirë, minon një nga përbërësit më të rëndësishëm të parandalimit: besueshmërinë. Megjithatë historia nuk mbaroi me kaq. Shumë për habinë e Argjentinës, Marina Britanike lundroi në Atlantikun e Jugut dhe ripushtoi ishujt. Gjeneral Galtieri, shefi i Juntës ushtarake të Argjentinës, më vonë pranoi se ai kurrë nuk besonte se një vend evropian do të ishte gati të paguante një çmim kaq të lartë për disa ishuj të parëndësishëm aq larg. Edhe Argjentina kishte llogaritur gabim. Por a nuk mund ta kishin menduar Galtieri dhe bashkatdhetarët e tij se një komb krenar si Mbretëria e Bashkuar nuk do të qëndronte duarkryq pasi një pjesë e territorit të saj jashtë shtetit po pushtohet nga një fuqi tjetër? A nuk duhet të dihej se të qenit pasiv do të kishte shënuar fundin për çdo qeveri britanike? Përgjigja: po, në kohë normale Argjentina mund të ketë menduar fare mirë skenarë të tillë. Megjithatë, në një krizë njerëzit priren të mendojnë sipas një lloji tjetër logjike. Në të vërtetë, shumë studime rreth sjelljes njerëzore

tregojnë se njerëzit që kanë frikë të humbasin diçka të vlefshme, janë gati të ndërmarrin rreziqe më të mëdha se ata që shpresojnë të fitojnë. Në kontekstin e Luftës së Falklands, kjo do të thotë se për Juntën, e cila ishte e rrethuar politikisht, pushtimi i “Malvinas” nuk ishte një fitim, por më tepër për shmangien e humbjes së pushtetit. Kjo i bëri ata të merrnin rreziqe që përndryshe nuk do të kishin guxuar t'i merrnin. Racionaliteti, një parakusht për një sistem të qëndrueshëm parandalues, kishte mbaruar.

“Duke parë politikën e brendshme ruse sot, mësimet e vitit 1982 ia vlen të rishikohen: nxitja e nacionalizmit për të gjeneruar mbështetje politike mund ta çojë njeriun në aventurizëm ushtarak, i cili mund të jetë vetëshkatërrues”. Të gjitha këto raste tregojnë se parandalimi nuk ka të bëjë vetëm me ekuilibrat ushtarakë, por edhe me interesat. Nëse interesi i kundërshtarit për arritjen e një objekti të caktuar është më i lartë se ai i dikujt, parandalimi mund të dështojë. Një shembull klasik është kriza e raketave Kubane e vitit 1962. Kur u bë e qartë se Uashingtoni ishte gati të mbronte interesat e tij kryesore të sigurisë, Bashkimi Sovjetik tërhoqi raketat që kishte filluar të vendoste në Kubë. Një shembull tjetër është Lufta e Vietnamit. Megjithëse Shtetet e Bashkuara ishin shumë më superiore ushtarakisht, në fund u desh të tërhiqeshin sepse vietnamezët e veriut dhe vietkongët ishin të gatshëm të bënin sakrificat shumë më të mëdha për të arritur qëllimet e tyre sesa ishin të gatshme të bënin SHBA-të në mbështetje të Vietnamit të Jugut. Ky grup asimetric interesash jo vetëm që bën që parandalimi të dështojë, por gjithashtu i bën fuqitë e mëdha të humbasin luftëra të vogla. Por çfarë ndodh me parandalimin bërthamor? A nuk duhet të mjaftojë frika nga fuqia e madhe shkatërruese e armëve të tilla për të garantuar praktikisht parandalimin? Përgjigja për këtë pyetje është e njëjtë me shembujt “konvencionalë” të përmendur më lart: edhe në fushën bërthamore, parandalimi varet nga interesat që dikush kërkon të mbrojtë. Nëse ekzistenca e një kombi është në rrezik, përdorimi i armëve bërthamore është i besueshëm. Prandaj, parandalimi midis shteteve me armë bërthamore konsiderohet të jetë relativisht “i qëndrueshëm”. Në të kundërt, shtrirja e parandalimit kombëtar bërthamor te aleatët është shumë më e ndërlikuar. Siç tha ministri britanik i Mbrojtjes Denis Healey në vitet 1960, nevojitet vetëm pesë për qind kredibilitet për të penguar rusët, por 95 për qind për të qetësuar evropianët. Pavarësisht kësaj

“teoreme Healey”, megjithatë, parandalimi i zgjeruar bërthamor është bërë një shtyllë qendrore e rendit ndërkombëtar. Ky nuk është vetëm rasti për NATO-n, por edhe për rajonin Azi-Paqësor, ku Japonia, Koreja e Jugut dhe Australia janë nën “ombrellën bërthamore” të SHBA-së. Është e diskutueshme të spekulohet nëse Shtetet e Bashkuara do të ishin vërtet të gatshme të rrezikonin përshkallëzimin bërthamor për të mbrojtur një aleat. Ajo që ka rëndësi është sinjali politik që Uashingtoni e shihet sigurinë e aleatëve të tij si një interes themelor të sigurisë kombëtare. Megjithatë, një mesazh i tillë do të jetë bindës vetëm nëse SHBA-ja është e pranishme ushtarakisht në ato rajone që pretendon t'i mbrojtë. Kjo siguron që në një konflikt Uashingtoni do të përfshihet që në fillim. Pa një prani të tillë, as aleatët dhe as kundërshtarët nuk do ta perceptonin një angazhim të tillë bërthamor si të besueshëm.

Çfarë përfundimesh mund të nxirren për politikën perëndimore të sigurisë?

“Së pari, një debat i rinovuar rreth parandalimit duhet të jetë i kujdesshëm për të mos e tepruar këtë koncept. Tundimi për të bërë pikërisht këtë është tashmë i dukshëm. Për shembull, disa studiues të paqes kanë argumentuar se armët taktike bërthamore të stacionuara në vende të ndryshme të NATO-s mund të tërhiqen, pasi ato nuk arrijnë të pengonin agresionin e Rusisë kundër Ukrainës”. Nëse kjo logjikë do të ishte e shëndoshë, do të duhej të shfuqizoheshin të gjitha ushtritë kombëtare, madje edhe vetë NATO. Sepse asnjë ushtri dhe asnjë aleancë nuk e ka penguar Rusinë nga aneksimi i Krimesë dhe destabilizimi i Ukrainës Lindore. Një analizë më realiste e situatës në Ukrainë do të zbulojë se “ky nuk është një rast parandalimi, sa është gjeografi dhe interesa”. Rusia është e gatshme “të parandalojë integrimin perëndimor të Ukrainës edhe me mjete ushtarake”, ndërsa Perëndimi “nuk është i gatshëm të rrezikojë një përshkallëzim ushtarak në emër të një vendi që nuk i përket NATO-s”. E thënë ndryshe, shembulli i Ukrainës “nuk është i përshtatshëm për të provuar ose falsifikuar parandalimin”. Sido që të jetë, kjo tregon se një vend që është politikisht dhe ushtarakisht i dobët është pre e lehtë për një fqinj të fuqishëm.

“Së dyti, duke pasur parasysh situatën aktuale të sigurisë në Evropë, detyra kryesore e NATO-s është të sigurojë mbrojtjen ushtarake të anëtarëve të saj më të ekspozuar gjeografikisht. Plani i Veprimit të Gatishmërisë (RAP) i ri i Aleancës parashikon rritjen e nivelit të gatishmërisë së forcave të reagimit të NATO-s dhe mbajtjen e stërvitjeve gjithnjë e më komplekse në Evropën Qendrore dhe Lindore”. RAP përfshin një forcë “majë shtize” të aftë për t'u dislokuar brenda disa ditësh, krijimin e një komandimi dhe kontrolli shumëkombësh të NATO-s dhe objektet e pritjes në territorin e disa aleatëve lindorë dhe përditësimin e planeve të mbrojtjes. Megjithëse theksi i NATO-s mbetet në projektimin e shpejtë të përforcimeve dhe jo në vendosjen e përhershme të forcave të konsiderueshme luftarake në Evropën Qendrore dhe Lindore, PVZH-ja pasqyron riafirmimin e një parimi që për disa kohë kishte marrë një hap të shkurtër, për të komunikuar parandalimin përmes një mbrojtjeje të besueshme duhet të përputhet me retorikën e tij me qëndrimin e duhur ushtarak.

Së treti, dimensionin bërthamor i parandalimit “do të duhet gjithashtu të rivizitohet”. Edhe pse jo në qendër të

vëmendjes së publikut, Rusia po dërgon gjithashtu sinjale bërthamore në Perëndim: duke rritur stërvitjet bërthamore, duke pasur bombardues rusë që fluturojnë më afër kufijve aleatë dhe duke u mburrur me zhvillimin e armëve të reja bërthamore. Në vjeshtën e vitit 2014, zëvendëskryeministri rus, Rogozin, madje premtoi se modernizimi ushtarak i Rusisë do të përmbante një “surprizë bërthamore” për kundërshtarët e mundshëm të vendit. E gjithë kjo zbulon se të menduarit e Rusisë, si politikisht ashtu edhe ushtarakisht, është shumë më i “nuklearizuar” nga sa besonin shumica e vëzhguesve perëndimorë. Perëndimi nuk ka nevojë të pasqyrojë qasjen e Rusisë. Megjithatë, do të duhet të pyesë veten nëse tendenca e pas Luftës së Ftohtë për të injoruar në masë të madhe parandalimin bërthamor dhe për të parë armët bërthamore kryesisht në kontekstin e çaromatimit është ende në përputhje me peizazhin e sotëm të sigurisë. Duke pasur parasysh sjelljen e Rusisë, si dhe rrezikun e shfaqjes së fuqive të reja bërthamore në Lindjen e Mesme dhe pjesë të Azisë, Perëndimi do t'i duhet të ri mësojë disa parime të humbura të parandalimit. Së katërti, parandalimi duhet të përfshijë edhe aspekte jo ushtarake. Në Ukrainë, Rusia ka dhënë një shembull shkollor të luftës hibride, përqendrimit i shpejtë i forcave të rregullta në kufirin e Ukrainës, punësimi i forcave speciale të pashënuara në Krime, mbështetja për separatistët në Ukrainën Lindore, një rritje në çmimin e gazit dhe një fushatë masive propagandistike që kërkonte të errësonte situatën në terren. Është e diskutueshme nëse kjo lloj lufte, e cila synon të krijojë paqartësi që mund të vështirësojë vendimmarrjen e NATO-s, mund të frenohet thjesht nga kërcënimi i forcës. Parandalimi i luftës hibride do të kërkojë gjithashtu mjete të tjera, të tilla si rritja e elasticitetit të rrjeteve kibernetike, diversifikimi i furnizimeve me energji dhe komunikimit strategjike që mund të korrigojnë me shpejtësi informacionin e rremë të përhapur nga një kundërshtar. Në vend që të ndëshkojë një agresor me reprezalje ushtarake, “frenimi nga rezistenca” kërkon ta shkëpusë atë duke demonstruar kotësinë e qasjes së tij.

Së pesti, Shtetet e Bashkuara mbeten pika kyçe e parandalimit perëndimor. Kjo nuk është vetëm për shkak të fuqisë së tyre të jashtëzakonshme ushtarake, por edhe vullnetit të tyre politik për të vepruar si garantues i rendit global. Nëse SHBA-të e humbin këtë vullnet, ose humbin aftësinë e tyre për ta përcjellë atë, të tjerët së shpejti do të testonin “vijat e kuqe” të ndryshme të tërhequra nga Uashingtoni. Pavarësisht një debati rreth prioriteteve të brendshme, SHBA-ja mbetet thellësisht e vetëdijshme për këtë fakt. Në fillim të krizës së Krimesë, SHBA-ja rriti shpejt pranimin e saj ushtarake në Evropën Qendrore dhe Lindore, duke mbështetur premtimet e saj për ndihmë me pajisje konkrete ushtarake.

Asgjë nuk mund të ilustron më mirë rëndësinë e madhe të pranisë së SHBA-së sesa një foto e një automjeti të blinduar amerikan në një autostradë në Lituani. Shumë lituanëzë ia dërguan foton njëri-tjetrit në celularët e tyre. Teksti poshtë figurës thoshte më shumë për parandalimin sesa një mijë tekste shkollorë: “E mrekullueshme! Megjithatë, ata mund të kishin ardhur 70 vjet më parë!”

Vasillaq Vangjeli, aktori me karrierë brilante, mbi katër dekada në skenë dhe ekran

Aktori i njohur Vasillaq Vangjeli është një nga personalitetet e artit shqiptar që është ulur dhe ka studiuar në bankat e Shkollës Ushtarake "Skënderbej". Edhe pse nisja e shkollimit në këtë shkollë i mundësonte një karrierë të ardhshme ushtarake, ai do të studioje më pas në një fushë tjetër dhe do të përkushtohet një jetë të tërë artit. Shkollimi i tij ka ecur në shumë drejtime, fillimisht për ushtarak, më pas për mjekësi dhe më pas në Akademinë e Artit. Një vend të rëndësishëm në formimet e para zë shkolla "Skënderbej", në të cilën ai nuk arriti të marrë maturën. Ja si e kujton në të gjallë të tij Shkollën Ushtarake "Skënderbej" Vangjeli: "... Ndërsa isha 14 vjeç, kur im atë më futi në shkollën 'Skënderbej', bëja kaq humor sa arritën e më larguan në vit të tretë. Të dhënat e aktorit i kisha që atëherë, madje arrita që 14 vjeç të transmetoja në gjuhën angleze ndeshjen imagjinare Angli - Shkolla 'Skënderbej'. Dhe vija në formacion të gjithë oficerët e shkollës me lojtarët e Anglisë. E gjithë shkolla qeshte me lot...". Në vitin e tretë të Mjekësisë, Vasillaq Vangjeli e braktis shkollën për të hyrë në Institutin e Lartë të Arteve (vitet 1973-1975). Pas përfundimit të tij e çuan për të bërë stazhin në teatër. Nga Teatri Popullor e kaluan në Estradën e Shtetit si aktor i humorit dhe që nga viti 1976 deri më 1 prill 2005 ka qenë aktor dhe regjisor në estradë dhe aktor i Estradës së Tiranës. Në këto kushte aktivizohej që atëherë në Estradën e Shtetit, që nga viti 1967-1968 kur ka qenë regjisor Bujar Kapexhiu.

Për rreth 45 vjet në skenë, me intuitë të hollë e spontanitet të admirueshëm Vangjeli ka bërë për vete me qindramijëra spektatorë, duke u kthyer kështu në një ndër artistët më të dashur për ta e sidomos në fushën e humorit e të skenës. Ka qenë ndër artistët më të rëndësishëm të Estradës së Tiranës,



duke luajtur pothuaj në të gjitha premierat. Ishte një aktor me diapazon të gjerë, vokal, vesh absolut, humorist, recitues. Aktor tragjik-komik me cilësi të mëdha artistike, intuitë e depërtues i thellë në tipa e karaktere, këto janë disa nga cilësitë e Vasillaqit, i cili me mjeshtëri e finesë di t'i verë në shërbim të asaj çfarë ai bën.

Puna në estradë ishte e madhe. Kishte 5 premiera që jepeshin në vit dhe shfaqjet bëheshin nga e marta në

të diel. Punoj me një kolektiv që do e cilësonte i shkëlqyer që nga Skënder Sallaku, babai i humorit të Estradës së Tiranës, Vegim Xhani, Behar Mera, Shpresa Bërdëllima, Rabije Hyka, Marjana Kondi, Rita Lati, Vera Veizi, Natasha Sela, etj. Aktori ka luajtur një mori parodish, kupletesh, skeçesh, pavarësisht se ajo çfarë ka pasur më shumë për zemër ishte interpretimi në komedi të gjata, prej 2-3 aktesh, si dhe në komedi muzikore, që ndryshe quhen

krijuese talentin dhe vlerat etike, u bë vendi ku realizoi ëndrrën aktorese. Vlerat i maten me rolet e interpretuara, e nuk janë pak. Të freskët e cilësor e plot shaka, i kalojnë të 100 role të krijuara në estradë, teatër, kinematografi, etj. Të gjithë i kujtojnë: Koçi tek "Zonja nga qyteti", "Një gjel në qymez", "Një mburravec që ka frikë nga pëllitja e lopës", "Dordoleci", "Donkishoti", ose rolin e Lolos, një lolo tragjik-komik me nuanca tepër fine të interpretimit. Të shumtë janë rolet në Estradë si: tek komedia e Vodëvil "Mirela", "Pa martuar 50-vjeçar" apo të kujtojmë skeçet e paroditë. Tani është i angazhuar me një rol në komedinë "Harvey". Komedi e bukur, rol i bukur. Shtëpinë e tij e kishte kthyer në lokal, ku argëtonte miqtë e tij, me humor dhe barcaleta, ngjarje të vërteta e të sajuara, "pjesë e profesionit".

E kështu jeta e Vasillaqit u pre, me



vodëvil. Humorin nuk ta jep shkolla, ajo vetëm të zhvillon, të drejton nëpërmjet dhuntive të lindura. E kështu ndodh edhe me Vasillaqin. Humori është i lindur që me lindjen e tij. Në rininë e hershme, sapo kishte mbaruar Akademinë e Arteve për aktrim, i filluan peripecitë e punës apo të emërimit ku do të punonte. Djalë i formuar e plot dëshirë. Kërkonte me çdo kusht të fillonte aktrimin në Teatrin Kombëtar, aq më tepër i dhanë edhe një rol tek drama "Lëvizja" me regji të Pirro Manit, rol që e realizoi me sukses. Por e emërojnë në Estradën e Tiranës... Estrada u bë vendi ku shpërfaqti me të gjitha energjitë

buzëqeshjen në buzë dhe me spektatorin që nuk e "tradhtoi" kurrë.

Ai ka lënë gjurmë dhe në kinematografi, ku mund të përmendim:

"Para nga qielli" (2009) komedi; "Piruet" (2005) komedi - serial; "Oreksi i madh" (1995) (TV); "Dashi pa brirë" (1993) komedi; "Gjuetia e fundit" (1992) (TV) komedi; "Mirela" (telekomedi) - (1988); "Kur ndahesh nga shokët" (1986) film; "Rrethimi i vogël" (1986) film; "Shoku ynë Tili" (1981) film; "Yjet mbi Drin" (1979); "Zonja nga qyteti" (1976) film; "Tokë e përgjakur" (1976); "Pylly i lirisë" (1976) film, "Partizani", etj...



Xhubleta Shqiptare, veshja unike, tashmë pasuri e gjithë njerëzimit

Veshje tipike e grave në Shqipërinë Veriore, mbi lumin Drin, Nikaj-Mërturi e Rugova, Malësi e Madhe dhe e shqiptarëve të Malit të Zi, në zonën e Nën Shkodrës deri në Breg të Matit, ku malësorët e Malësisë së Madhe kanë zbritur.

Xhubleta është një fund në trajtë kambane, që vjen i valëzuar për fundi, sidomos në pjesën e mbrapme. Përbëhet nga një numër i madh copash e rripash të ngushtë shajaku, qepur horizontalisht dhe të ndërthurur me breza gajtanësh. Mbahet e varur në supe me dy rripa të gjerë.

Xhubleta shqiptare, e lashtë 4 mijë vjet, është pranuar në listën Trashëgimisë Kulturore jo-materiale, nën mbrojtjen e UNESCO-s

Xhubleta është një veshje e punuar me dorë, që vishej nga gratë dhe vajzat malësore në Shqipërinë e Veriut, por edhe në një pjesë të Malit të Zi dhe Kosovës.

Është kryesisht e zezë, e punuar në masë të madhe me pëlthurë leshi dhe me motive të qëndisura shumëngjyrëshe. Karakteristikë e saj është pjesa e poshtme në formë të kabanës.

Filja, sot 70 vjeçe, kujton ende në detaje gjithçka nga procesi i bërjes së një xhublete.

“E zgjidhnim leshin e deles ku ishte më i miri, e shprishnim, e lërnurim dhe e turrnim. Mjetet që duheshin për ta përgatitur xhubletën, ishin: koshi i spikut, veku dhe vajanica. Tirkur bëhej në vek (tezgjah) dhe kur përfundonte, e çonim në vajanicë, që ka qenë një vegël prej druri... Ishin si dy çekiçë prej druri që komandoheshin nga forca e ujit, godisnin tirkun dhe krejt copa ngjeshej”, - kujton Filja për “Radio Evropa e Lirë”.

Javën e kaluar, Agjencia e Kombeve të Bashkuara për Arsim, Shkencë dhe Kulturë (UNESCO) e mori nën mbrojtje xhubletën.

Kjo veshje, e vjetër 4 mijë vjet, dikur përdorej në jetën e përditshme.

Megjithatë, përdorimi dhe prodhimi i saj ka qenë në rënie gjatë dekadave të fundit, si për arsye socio-politike, ashtu edhe për arsye



ekonomike.

Filja kujton se në kohën e rinisë së saj nuk kishte bojëra për të ngjyrosur leshin e deles, por se ato bëheshin duke zier lëvozhga verri, gjethe frashri, si dhe një gur me ngjyrë blu që thotë se quhej karaboj.

Tetë xhubleta në pajë

“Unë jam martuar me xhubletë dhe kam pasur tetë xhubleta në pajë. Më e mira ishte ajo që veshja kur u bëra nuse dhe e përdorja kur kishim festa. Xhubleta pas së mirës ishte ajo që e vishja kur të afërmit na ftonin

në dreka dhe darka, ndërsa të tjerat i kisha për t'i mbajtur përditë”, - thotë Filja.

Me keqardhje, ajo tregon se sot i ruan vetëm dy prej tyre.

“Ishin kohë të vështira, varfëri... Të besohet që gjashtë xhubleta i kam prishur dhe me to kam bërë qilima, apo shtrojë, apo mbulojë? Më vjen të qaj kur e kujtoj. Më janë dhimbsur shumë kur i kam prishur se i kisha bërë me këto duar, por nuk kam pasur rrugë tjetër”, - thotë Filja.

Ajo nuk jeton më në fshatin e saj të lindjes, Vermosh, ku edhe mësoi zanatin, por në Shkodër.

Për ta ruajtur këtë traditë, por edhe për të siguruar të ardhura për veten dhe bashkëshortin, Filja, në shtëpinë e saj, vazhdon të qepë xhubleta dhe tirq, veshje që dikur përdornin burrat malësorë.

Ajo thotë se numrin më të madh të porosive e ka nga emigrantët në Shtetet e Bashkuara.

“Ata i duan xhubletat dhe tirqit ashtu siç kanë qenë dikur, origjinale. Është një punë që merr shumë kohë.

Më duhet t'i blej stolitë, t'i mbledh nëpër zona të ndryshme, dikush shet një varësë, dikush hajmalinë, dikush postavën, apo brezin e hekurit që kanë mbajtur gratë dikur...”, - rrëfen Filja.

Ajo thotë se më së shumti punon imitime të xhubletës, pasi kështu mund t'ia dalë për të siguruar më lehtë të ardhura. Për ta qepur atë në formën origjinale, thotë se i duhet mbështetje edhe nga institucionet.

Xhubleta për raste të ndryshme
Për të punuar një xhubletë dasme apo festash, duhen gjashtë deri në

nëntë muaj kohë.

Xhubletat e përditshme, kërkojnë në më pak kohë, sepse nuk kanë punime të veçanta dhe qëndisje.

Xhubleta e ‘vdekjes’ (që ruhej dhe vishej kur varrosej një grua) gjithashtu ka kërkuar kohë, sepse ka pasur shumë punime në pjesën e përparme të saj.

Rikthehet tradita e daljes së nuses me xhubletë

Në zonën e Kelmendit, pjesa veriore e Shqipërisë, shumë familje i ruajnë xhubletat e hershme.

“Është e vështirë ta mbash dhe ta veshësh. Xhubleta duhet palosur me kujdes që konet e saj të rrinë në pozicionin e duhur. Jo kushdo di ta ruajë dhe ta veshë”, - thonë punueset e xhubletës.

“Ta shohësh një nuse nga afër me xhubletë, ishte shumë bukur”, - shprehen ato.

Një prej stolive që ruajnë, është edhe varësja e mashave.

“Xhubleta ka pasur shumë qëndisje dhe shumë stoli. Peshonte rreth 14-15 kilogramë si veshje. Një prej stolive ishte edhe varësja e mashave, që gruaja malësore e mbante varur në qafë. Në fund të varësës është një si gërshtë e vogël. Me të, gruaja merrte një gacë nga oxhaku dhe ndizte çibukët e burrave në odë”.

Ato thonë se një tjetër pjesë e stolive ka qenë edhe hajmalia, ku nuses i hidheshin napolona ari gjatë kërcimit.

Xhubleta nuk është thjesht një veshje, ajo është rit, kulturë shekullore, traditë

Të vishje një xhubletë nuk ishte thjesht një rutinë e përditshme.

Në shek. XVIII, xhubleta përbëhej nga shumë ngjyra, por ato që na kanë mbërritur në ditët e sotme janë: të zeza për gratë dhe bardhë e zi për vajzat. Pjesë të tjera të kostumit me xhubletë janë: kraholinë, xhoka, kërdhokla, paraniku, kallmat e shputat, etj.

Xhubleta është me prejardhje të lashtë. Paraqet ngjashmëri me veshjen e disa figurinave neolitike të gjetura në Bosnje, por edhe në vise të tjera të Mesdheut, që i përkasin mijëvjeçarit të dytë para erës sonë dhe lidhen me qytetërimet e vjetra mesdhetare.

Xhubleta e Malësisë është trashëgimi e qartë e prejardhjes ilire të kulturës tonë, që malësorët e përcollën deri në vitet 1950-1960, pra përbën një nga elementët identifikues të veshjes popullore shqiptare, nëpërmjet motiveve, ku emblema për të gjitha është shqiponja.



EIB Global mbështet zhvillimin e qëndrueshëm në Shqipërinë e Veriut

Një grant i asistencës teknike globale të EIB - European Investment Bank (Banka Europiane e Invesimeve - BEI) do të mundësojë përgatitjen e një plani investimesh kapitale dhe mobilizimin e investimeve private në qarqet Shkodër dhe Lezhë.

Projektet do të përmirësojnë lidhjen e zonës, cilësinë mjedisore dhe ofertën turistike.

Qëllimi është të shfrytëzohet potenciali i rritjes së Shqipërisë së Veriut dhe vijës bregdetare të Adriatikut me fokus zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik.

EIB Global, dega e Bankës e fokusuar në operacionet jashtë Bashkimit Evropian, do të japë një grant asistence teknike prej 2.75 milionë euro për Fondin Shqiptar të Zhvillimit (FSHZH) për përgatitjen e një programi investimi prioritar. Programi do të mbulojë zonën afër kufirit me Malin e Zi përgjatë liqenit të Shkodrës dhe lumit Buna në portën kryesore për në Alpet Shqiptare. Pas përfundimit të një strategjie të integruar të turizmit dhe zhvillimit urban – e cila është gjithashtu pjesë e mbështetjes këshillimore të BEI-së – kjo asistencë teknike do të fokusohet në dhënien e vlerësimeve mjedisore, teknike dhe sociale dhe në afrimin e projekteve të përzgjedhura me fazën e zbatimit.

Projektet do të mundësojnë ndërtimin e infrastrukturës mjedisore, transportit lokal, urban dhe turistik në qarqet e Shkodrës dhe Lezhës, duke rezultuar në rritjen socio-ekonomike dhe përmirësimin e lidhjes, cilësisë mjedisore dhe ofertës turistike të zonës.

Nënkryetarja e EIB, Lilyana Pavlova, përgjegjëse për Ballkanin Perëndimor, tha: “Jemi të lumtur që jemi në gjendje të mbështesim rihvillimin e një zone kaq të rëndësishme për zhvillimin e qëndrueshëm socio-ekonomik të Shqipërisë. Ky program investimi i synuar që do të hartohet në kuadër të grantit Global të EIB-së do të ofrojë njohuri për nevojat specifike infrastrukturore që do të ndihmojnë në rritjen e elasticitetit ndaj ndryshimeve klimatike, lidhjes dhe aftësive për mbrojtjen e mjedisit, për të përmbushur standardet më të larta dhe për të korrur potencialin e plotë ekonomik të Shqipërisë së Veriut.

Dritan Agolli, Drejtor Ekzekutiv në Fondin Shqiptar të Zhvillimit, tha: “Për më shumë se një dekadë, qeveria shqiptare ka synuar të reformojë qasjen ndaj zhvillimit rajonal dhe lokal drejt një sistemi më efikas që harmonizon dhe integron ndërhyrjet sektoriale dhe vendore në territor. Nëpërmjet kësaj nisme synojmë të ndërtojmë një program gjithëpërfshirës investimesh që do t'i përgjigjet nevojave dhe potenciale territoriale, duke përmirësuar atraktivitetin e kësaj zone, do të nxisë potencialin e gjenerimit ekonomik, do të investojë në njerëz dhe shërbime, si dhe do të përmirësojë shërbimet publike.



Fondi Shqiptar i Zhvillimit sheh në BEI një partner të rëndësishëm në arritjen e misionit të tij, në mbështetje të synimeve dhe objektivave të qeverisë shqiptare”.

Zonat që do të mbuloohen nga asistencë teknike e EIB Global janë vija bregdetare e Adriatikut midis Shëngjinit dhe Velipojës, brigjet e liqenit të Shko-

drës, lumi Buna dhe porta e Koplikut për në Alpet Shqiptare, si dhe bashkitë Shkodër, Lezhë dhe Malësi e Madhe.

EIB Global

EIB Global është krahu i specializuar i Grupit EIB, i dedikuar rritjes së ndikimit të partneriteteve ndërkombëtare dhe financave të zhvillimit. EIB

Global është krijuar për të nxitur partneritet të fortë dhe të fokusuar brenda Ekipit të Evropës, krahas institucioneve të tjera financiare të zhvillimit dhe shoqërisë civile.

Fondi Shqiptar i Zhvillimit

Fondi Shqiptar i Zhvillimit (FSHZH) është një agjenci e krijuar

me ligj të veçantë në vitin 1993 si një agjenci sociale, fondi i investimeve për zbutjen e varfërisë në vend. Që nga misioni i saj fillestar për të zbutur varfërinë në zonat rurale të Shqipërisë me ndërhyrje të vogla, pas rënies së regjimit komunist, FSHZH është shndërruar në organin kryesor të zhvillimit. Ai zbaton qasje rajonale dhe zbaton projekte të integruara dhe komplekse që sigurojnë zhvillim të qëndrueshëm social dhe ekonomik, si dhe krijimin e modeleve të suksesshme, dhe i përkthen ato në rezultate me një ndikim afatgjatë në mirëqenien e njerëzve. Vitet e fundit, FSHZH ka marrë një rol gjithnjë e më të rëndësishëm në reformën e zhvillimit rajonal.

EIB në Ballkan

EIB është një financues kryesor ndërkombëtar në Ballkanin Perëndimor. Që nga viti 2009, Banka ka financuar projekte në një total prej gati 10 miliardë eurosh në rajon. Përveç mbështetjes së vazhdueshme për rindërtimin dhe përmirësimin e infrastrukturës publike, që nga viti 2010, EIB është zgjeruar në shumë fusha të reja, si kujdesi shëndetësor, kërkimi dhe zhvillimi, arsimit dhe ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (SME).

EIB në Shqipëri

EIB ka qenë aktive në Shqipëri që nga viti 1995. Deri më sot janë financuar 26 projekte dhe janë investuar mbi 640 milionë euro, kryesisht në infrastrukturën kryesore të transportit, energjisë, ujit dhe ujërave të zeza.

Një kuadër i ri i sigurisë shëndetësore të BE-së

Që nga sot, bllloqet e ndërtimit të Bashkimit Evropian të Shëndetësisë janë zyrtarisht në funksion. Kjo jo vetëm që përfshin rregulla më të forta të BE-së për kërcënimet serioze ndërkufitare për shëndetin, por edhe një mandat më të fortë të Qendrës Evropiane për Parandalimin dhe Kontrollin e Sëmundjeve (ECDC) dhe një Kuadër të re Emergjente për kundërmasat mjekësore. Marrë së bashku me një mandat të zgjatur të Agjencisë Evropiane të Barnave (EMA) dhe themelimin e Autoritetit të Përgatitjes dhe Reagimit ndaj Emergjencave Shëndetësore (HERA), BE-ja tani ka mjetet e nevojshme për t'u përgatitur dhe për t'u përgjigjur më mirë në rast të një emergjence të shëndetit publik.

Hyrja në fuqi e këtyre rregullave të reja plotëson kapacitetet e gatishmërisë dhe reagimit të Bashkimit Evropian të Shëndetësisë, duke krijuar një kuadër ligjor të fortë për të përmirësuar kapacitetin e BE-së

në fushat jetike të parandalimit, gatishmërisë, mbikëqyrjes, vlerësimit të rrezikut, paralajmërimit të hershëm dhe reagimit.

Rregullorja për kërcënimet serioze ndërkufitare për shëndetin tani i jep BE-së:

- Një planifikim të fuqishëm gatishmërie dhe një sistem më të integruar mbikëqyrjeje
- Një kapacitet më të mirë për vlerësimin e saktë të rrezikut dhe reagimin e synuar
- Mekanizma solidë për prokurimin e përbashkët të kundërmasave mjekësore
- Mundësia për të miratuar masa të përbashkëta në nivel të BE-së për të adresuar kërcënimet e ardhshme ndërkufitare shëndetësore

Një ECDC më e fortë tani është në gjendje jo vetëm t'u japë rekomandime Shteteve Anëtare në lidhje me gatishmërinë ndaj kërcënimeve shëndetësore, por gjithashtu të presë një rrjet të ri ekselence të laboratorëve referencë të BE-së dhe të krijojë një Task Forcë Shëndetësore të BE-së për ndërhyrje të shpejta shëndetësore në rast të një shpërthimi të madh.

Për të qenë efektiv dhe funksional në kohë emergjencash të shëndetit publik, Rregullorja Kuadër e Emergjencave tani lejon themelimin brenda HERA-s të një Bordi të Krizave Shëndetësore. Ky Bord do të koordinojë me shpejtësi në nivel të BE-së furnizimin dhe aksesin ndaj kundërmasave mjekësore. Rregullorja gjithashtu mundëson aktivizimin e fabrikave të BE-së, planet e kërkimit emergjent dhe inovacionit dhe aksesin në financimin e emergjencës.



Prekja njerëzore: 'Inteligjenca e Përgjithshme Artificiale' është faza e radhës e AI

Inteligjenca artificiale po transformon me shpejtësi të gjithë sektorët e shoqërisë sonë. Pavarësisht nëse e kuptojmë apo jo, sa herë që bëjmë një kërkim në Google ose i bëjmë një pyetje Sirit, ne përdorim AI (Artificial Intelligence).

Për mirë apo për keq, e njëjta gjë vlen edhe për vetë karakterin e luftës. Kjo është arsyeja pse Departamenti i Mbrojtjes në SHBA, Kinë dhe Rusi, po investojnë miliarda dollarë për të zhvilluar dhe integruar AI në sistemet e mbrojtjes. Është gjithashtu arsyeja pse DoD tani po përqafton iniciativat që parashikojnë teknologjitë e ardhshme, duke përfshirë fazën tjetër të AI - Inteligjencën e Përgjithshme Artificiale.

AGI është aftësia e një agjenti inteligjent për të kuptuar ose mësuar çdo detyrë intelektuale në të njëjtën mënyrë si njerëzit. Ndryshe nga AI, që mbështetet në grupe të dhënash gjithnjë në zgjerim për të kryer detyra më komplekse, AGI do të shfaqë të njëjtattribute si ato të lidhura me trurin e njeriut, duke përfshirë sensin e përbashkët, njohuritë në sfond, të mësuarit e transferimit, abstraksionin dhe shkakësinë. Me interes të veçantë është aftësia njerëzore për të përgjithësuar nga të dhëna të pakta ose jo të plota.

Ndërsa disa ekspertë parashikojnë se AGI nuk do të ndodhë kurrë ose të paktën është qindra vjet larg, këto vlerësime bazohen në qasjen e simulimit të trurit ose përbërësve të tij. Ka shumë shkurtime të mundshme për AGI, shumë prej të cilave do të çojnë në çipa të personalizuar AGI për të rritur performancën në të njëjtën mënyrë që GPU-të e sotme përshpejtojnë mësimin e makinerive.

Prandaj, një numër në rritje i studiuesve besojnë se fuqia e mjaftueshme kompjuterike tashmë ekziston për të arritur AGI. Edhe pse ne përgjithësisht e dimë se çfarë bëjnë pjesët e trurit, ajo që mungon, megjithatë, është njohuria se si funksionon truri i njeriut për të mësuar dhe kuptuar detyrat intelektuale.

Duke pasur parasysh sasinë e kërkimeve që po zhvillohen aktualisht - dhe kërkesën për kompjuterë të aftë për të zgjidhur problemet që lidhen me njohjen e të folurit, vizionin kompjuterik dhe robotikën - shumë ekspertë parashikojnë se shfaqja e AGI ka të ngjarë të ndodhë gradualisht brenda dekadës së ardhshme. Aftësitë e reja AGI po vazhdojnë të zhvillohen dhe në një moment do të jenë të barabarta me aftësitë njerëzore.

Por me rritjen e vazhdueshme të performancës së harduerit, AGI-të e mëvonshme do të tejkalojnë shumë aftësitë mendore njerëzore. Nëse kjo do të thotë të "mendosh" më shpejt, të mësosh më lehtë detyra të reja ose të vlerësosh më shumë faktorë në vendimmarrje, mbetet për t'u parë. Sidoqoftë, në një moment, konsensusi do të jetë se AGI-të kanë tejkaluar aftësitë mendore njerëzore.

Fillimisht, do të ketë shumë pak makina të vërteta "të të menduarit". Megjithatë, gradualisht, këto makina fillestare do të "piqen". Ashtu si drejtuesit e sotëm rrallë marrin vendime financiare pa u konsultuar



Ndryshe nga njerëzit, AGI-të nuk do të kenë nevojë për para, fuqi, territor dhe as nuk duhet të shqetësohen për mbijetesën e tyre individuale. (Imazhi nga Universiteti "Purdue")

me tabelat, kompjuterët AGI do të fillojnë të nxjerrin përfundime nga informacioni që përpunojnë. Me përvojë më të madhe dhe fokus të plotë në një vendim specifik, kompjuterët AGI do të jenë në gjendje të arrijnë zgjidhjet e sakta më shpesh sesa homologët e tyre njerëzorë, duke rritur më tej varësinë tonë prej tyre.

Në mënyrë të ngjashme, vendimet ushtarake do të fillojnë të merren vetëm në konsultim me një kompjuter AGI, i cili gradualisht do të fuqizohet për të vlerësuar dobësitë konkurruese dhe për të rekomanduar strategji specifike. Ndërsa skenarët e fantashkencës në të cilat këtyre kompjuterëve AGI u jepet kontroll i plotë mbi sistemet e armëve dhe ndezin zotërit e tyre janë shumë të pamundur, ata padyshim do të bëhen pjesë përbërëse e procesit të vendimmarrjes.

Ne do të mësojmë kolektivisht të respektojmë dhe t'u japim besim rekomandimeve që bëjnë kompjuterët AGI, duke u dhënë atyre gjithnjë e më shumë peshë ndërsa demonstrojnë

nivele gjithnjë e më të mëdha suksesi.

Natyrisht, përpjekjet e hershme të AGI-ve do të përfshijnë disa vendime të dobëta, ashtu siç do të bënte çdo person i papërvojë. Por në vendimet që përfshijnë sasi të mëdha informacioni të cilat duhet të jenë të balancuara, dhe parashikimet me variabla të shumtë, aftësitë e kompjuterëve - të lidhura me vite të trajnimit dhe përvojës - do t'i bëjnë ata vendimmarrës strategjikë superiorë.

Gradualisht, kompjuterët AGI do të fillojnë të kenë kontroll mbi pjesë më të mëdha të shoqërisë sonë, jo me forcë, por sepse ne i dëgjojmë këshillat e tyre dhe i ndjekim ato. Ata gjithashtu do të bëhen gjithnjë e më të aftë për të lëkundur opinionin publik përmes mediave sociale, për të manipuluar tregjet dhe për të qenë edhe më të fuqishëm në përfshirjen në llojet e mbrojtjeve të infrastrukturës të synuara aktualisht nga hakerët e sotëm njerëzorë.

AGI-të do të jenë sisteme të drejtu-

ara nga qëllimet në të njëjtat mënyra si njerëzit. Ndërsa qëllimet njerëzore kanë evoluar gjatë epokave të sfidave të mbijetesës, qëllimet AGI mund të vendosen të jenë çdo gjë që na pëlqen. Në një botë ideale, synimet AGI do të vendoseshin për të mirën e njerëzimit në tërësi.

Por, çka nëse ata që fillimisht kanë kontrollin e AGI-ve nuk janë kujdestarë dashamirës që kërkojnë të mirën më të madhe? Po sikur pronarët e parë të sistemeve të fuqishme t'i përdorin ato si mjete për të sulmuar aleatët tanë, për të minuar ekuilibrin ekzistues të fuqisë ose për të marrë nën kontroll botën? Po sikur një despot individual të marrë kontrollin e AGI-ve të tilla? Ky padyshim do të përbënte një skenar jashtëzakonisht të rrezikshëm që Perëndimi duhet të fillojë ta planifikojë tani për tani.

Ndërsa ne do të jemi në gjendje të programojmë motivimet e AGI-ve fillestare, motivimet e njerëzve ose

korporatave që krijojnë ato AGI do të jenë jashtë kontrollit tonë.

Dhe le ta pranojmë: njerëz individualë, kombe, madje edhe korporata kanë sakrifikuar historikisht të mirën e përbashkët afatgjatë për fuqi dhe pasuri afatshkurtër.


Dritarja e mundësive për një shqetësim të tillë është mjaft e shkurtër, vetëm brenda brezave të parë të AGI-së. Vetëm gjatë asaj periudhe njerëzit do të kenë një kontroll kaq të drejtpërdrejtë mbi AGI-të sa që ata do të bëjnë padiskutim kërkesat tona. Më pas, AGI-të do të vendosin qëllime për përfitimin e tyre, të cilat do të përfshijnë eksplorimin dhe mësimin dhe nuk duhet të përfshijnë ndonjë konflikt me njerëzimin.

Në fakt, përveç energjisë, AGI-të dhe nevojat njerëzore janë kryesisht të palidhura.

AGI-të nuk do të kenë nevojë për para, fuqi, territor dhe as nuk duhet të shqetësohen për mbijetesën e tyre individuale - me kopje rezervë të përshtatshme, një AGI mund të jetë efektivisht i pavdekshëm, i pavarur nga çdo harduer në të cilin po funksionon aktualisht.

Megjithatë, për atë periudhë ka një rrezik. Dhe për sa kohë ekziston një rrezik i tillë, të qenit i pari që zhvillon AGI duhet të jetë një përparësi kryesore.

Charles Simon është CEO i "FutureAI", një kompani teknologjike në fazat e hershme që zhvillon algoritme për AI. Ai është autor i "A do të revoltojë kompjuterët? Përgatitja për të Ardhmen e Inteligjencës Artificiale", dhe zhvilluesi i "Brain Simulator II", një platformë softuerike kërkimore AGI, dhe "Sallie", një softuer prototip dhe entitet artificial që mëson në kohë reale me vizion, dëgjim, të folur dhe lëvizshmëri.



Doktor Mikado Shakohoxha, ushtaraku madhor me kontribute në fushën e shkencës ushtarake

Mikado Shakohoxha u lind në Vranisht të Vlorës, në janar të vitit 1943 nga një familje me tradita të njohura atdhetare. Pas mbarimit me sukses të shkollës shtatëvjeçare në vendlindje, Mikado Shakohoxha, në vitin 1957, nis studimet në Shkollën e Mesme Ushtarake "Skënderbej". Pasi e përfundon këtë shkollë me rezultate të mira, dërgohet për vazhdimin e studimeve ushtarake në Shkollën e Bashkuar të Oficerëve në Tiranë. Edhe këtë shkollë e përfundon me rezultate të mira dhe titullohet oficer aktiv, duke nisur punë në strukturat e Ministrisë së Mbrojtjes. Gjatë karrierës së gjatë si oficer aktiv, Mikado Shakohoxha ka kryer dhe shkollime të tjera, përkatësisht Akademinë e Shtabit të Përgjithshëm në Tiranë, Shkollën e Lartë të Partisë "Vladimir Iliç Lenin" në Tiranë si dhe Kursin e Lartë të Filozofisë, po në Tiranë. Shakohoxha mban gradën shkencore "Doktor" dhe titullin shkencor "Docent". Në Shkollën Ushtarake "Skënderbej", Shakohoxha, si gjithë skënderbegasit, mori njohuritë e para për jetën e bukur ushtarake.

"Me dëshirën time vështirë rrobën ushtarake pa mbushur 14 vjeç. Nisa një rrugë të cilën nuk mund ta merrja me mend dhe do të kërkonte aq shumë sakrificë, se profesioni i ushtarakut do të më shoqëronte gjithë jetën. Këtë



profesion nuk ma la babai si shumë të tjerëve, por mjaft kushërinj e bashkëfshatarë si Eqeremi, Ramadani, Simoni, Tajari, Shabani, Maksi, etj... Ata vazhdonin shkollën 'Skënderbej', ku fillimisht uniforma e bukur dhe edukata e tyre ushtarake më tërhoqën shumë", - kujton Shakohoxha.

Mikado Shakohoxha ka shërbyer si ushtarak në shumë rrethe të vendit, duke kryer detyra të rëndësishme në Shtabin e Përgjithshëm të Ushtrisë, në Grupimin e VI Operativ (Korpus) të Tiranës, komandant i Grupimit (Divizionit) të Tiranës. Krahas karrierës së suksesshme dhe rezultateve të vlerësuar në strukturat e Ministrisë së Mbrojtjes, Mikado Shakohoxha ka dhënë një kontribut të rëndësishëm në fushën e shkencës ushtarake, personalisht si dhe në drejtimin e Sektorit Shkencor të Ushtrisë. Njëkohësisht, në karrierën e suksesshme të Shakohoxhës, janë dhe vitet kur ai ka dhënë mësim në Akademinë e Shtabit të

Përgjithshëm të Ushtrisë. Detyra e fundit që Shakohoxha ka kryer është ajo e shefit të Sektorit Shkencor të Ushtrisë, ku në kuadër të reformës, ndonëse ishte vetëm 48 vjeç, në vitin 1992 del në lirim. Grada më e lartë që Shakohoxha ka arritur në strukturat e Mbrojtjes, ishte ajo e "kolonelit".

Në morinë e punës së tij shkencore ushtarake përfshihen një seri kumtesash, referatesh e studimesh të mbajtura në Konferenca Shkencore, botuar si studime më vete apo në bashkëpunim në medie, udhëheqje punimesh shkencore e dispencash me objekt problemet e mbrojtjes dhe të sigurisë, etj... Për këto punime dhe sukseset që ka arritur në drejtimin e njëjësive, repartëve të ushtrisë e sektorëve shkencorë, Mikado Shakohoxha ka marrë vlerësime të shumta zyrtare, përfshi mirënjohje e dekorata. Pas daljes së parakohshme në rezervë, Shakohoxha nuk shkëputet nga studimet ushtarake e jeta shoqërore, duke kontribuar vazhdimisht.

Kontributi me vlera i Doktor Taqo Trajçes në shkencat ushtarake

Doktori i Shkencave Ushtarake Taqo Stilian Trajçe u lind në Korçë, më 1 shkurt të vitit 1953, dhe banon në Tiranë. Është i martuar dhe ka dy fëmijë. Pas arsimit fillor në vendlindje, ai kryen Shkollën e Mesme Ushtarake "Skënderbej" në vitet 1966-1970. Ndërsa Shkollën e Bashkuar të Oficerëve "Enver Hoxha" (sot "Akademia 'Skënderbej'"), e ka kryer në vitet 1970-1972. Kompletimit arsimor si ushtarak karriere, Taqo Trajçes, i shërben dhe Akademia Ushtarake të cilën e kreu me rezultate të mira, në vitet 1980-1982. Në vitin 1998 ai shkon për kualifikim në Kolegjin e Mbrojtjes në Itali (NATO Defense College), ku vlerësohet shumë mirë. Ndërsa në vitin 1999, dërgohet dhe kryen Kursin e Lartë Ekzekutiv (Senior Executive Course 95-5) në Qendrën "George C. Marshall" në Garmish të Gjermanisë. Me Nr. 351, datë 30.06.1993, fiton gradën "Doktor i Shkencave Ushtarake". Zotëron gjuhën angleze. Pasi punon 10 vjet në Vlorë dhe Fier si instruktor stërvitje në Shkollën e Instruksionit dhe të njëjtin funksion edhe në Korpusin e Fierit dhe pasi kryen Akademinë e Mbrojtjes në vitet 1980-1982, fillon punë në Tiranë si punonjës shkencor në Degën e Artit Ushtarak të Sektorit Shkencor të Aka-



demisë së Mbrojtjes, detyrë të cilën e kryen deri në vitin 1986. Për dy vitet në vazhdim, është pedagog në Katedrën e Përgatitjes Taktiko-Operative po në këtë Akademi... Në vitet 1988-1989

është zëvendëskomandant i Shkollës së Bashkuar të Oficerëve për anën shkencore. Nxirret në rezervë në tetor të vitit 1992 dhe ri-vishet përsëri në vitin 1999 dhe emërohet shef i Shtabit

të Akademisë së Mbrojtjes në Tiranë. Nga nëntori 2001 deri në maj të vitit 2006 është shef i Qendrës së Doktrinave Ushtarake; në maj 2006-mars - 2008 është zëvendëskomandant i Komandës së Doktrinës së Stërvitjes. Në vitin 1992 del në rezervë, ndërsa në tetor të vitit 1997 emërohet shef i Shtabit në Akademinë e Mbrojtjes në Tiranë. Nga nëntori 2002 deri në maj të vitit 1946 është shef i Qendrës së Doktrinave, Manualeve dhe Botimeve në Komandën e Doktrinës së Stërvitjes. Në vazhdim është pedagog në Qendrën e Doktrinës së Manualeve në Akademinë e Mbrojtjes "Spiro Moisiu" në Tiranë. Aktiviteti i tij shkencor në botime librash dhe studimesh: Autor i librit "Organizimi dhe funksionimi i shtabit"; "Termet Operativë", 528 faqe, viti 2001; Organizimi dhe funksionimi i Komandës së Doktrinës dhe të Stërvitjes", Tiranë 528 faqe; Autor i studimit "Defense Review", anglisht, në bashkëpunim me ekipin e SAIC-ut, Tiranë 2001; Autor

i "Teknika dhe procedura të komandimit", botim doktrinar, 227 faqe, viti 2005; "Fjalor i termave operativë", viti 2005; "Plani afatgjatë i zhvillimit të Forcave të Armatosura-vizion 2020", me bashkautor, viti 2006; "Strategjia Ushtarake e Republikës së Shqipërisë", viti 2008; "Operacioni i përbashkët dhe shumëkombësh", 225 faqe, viti 2009; "Rregullore rreshtore e Forcave të Armatosura", bashkautor, viti 2009; "Rregullore e Qendrës së Bashkuar Operacionale", bashkautor; "Doktrina e përbashkët e Aleancës për kryerjen e Operacioneve", shqipërim i Doktrinës së NATO-s, 120 faqe, etj...

Është gjithashtu autor i 35 punimeve shkencore, referateve dhe kumtesave për problemet e mbrojtjes, sigurisë, referuar në Shqipëri, vendet aleate të NATO-s, përfshi dhe SHBA-të.

Ka kryer këto detyra: Zëvendëskomandant i Shkollës së Bashkuar të Oficerëve (1988 - 1989); Shef i Shtabit të Akademisë së Mbrojtjes (1997-1999); Shef i Mësimin në Akademinë e Mbrojtjes (1999-2001); Shef i Qendrës së Doktrinës (nëntor 2001 - maj 2006); Zëvendëskomandant i Doktrinës së Stërvitjes (maj 2006 - mars 2008)...

**Kujtim Boriçi,
Maksim Fejzullai**

79 VJET

nga Konferenca e Bujanit

Konferenca e Bujanit ka filluar më 31 dhjetor 1943 dhe ka përfunduar më 2 janar 1944. Aty është nënshkruar një rezolutë, ku Kosovës i njihet e drejta e vetëvendosjes deri në shkëputje dhe realizimi i dëshirës së popullit shqiptar të Kosovës për bashkim me Shqipërinë.

Konferenca e Bujanit është mbajtur si rikonfirmim i rrethanave të reja të krijuara pas Mbledhjes së Mukjes, si dhe rezultat i mos përfshirjes së Kosovës dhe viseve tjera shqiptare nën sundimin e ish-Mbretërisë SKS, (Konferenca e Bujanit), e cila u mbajt pikërisht për t'i kundërshtuar vendimet e Mbledhjes së II të AVNOJ-it në Jajcë (29-30 nëntor 1943) dhe mos përfshirjes së Kosovës si subjekt i pavarur që deri atëherë ishte përfaqësuar përmes Malit të Zi në KAKJ-së.

Bujani, si një vend pritje i përfaqësuesve të dy kombësive (shqiptarëve dhe serbëve), që kërkonin një marrëveshje për parandalimin e konflikteve të mëtejshme ndëretnike. Mbledhja e Konferencës u mbajt në kullën e Sali Manit, Bajraktarit të Krasniqes, që ndodhej pranë bazës së Shtabit Kryesor të UNÇ-së të Kosovës dhe të Komitetit Krahinor për Kosovën e Rrafshin e Dukagjinit, ku morën pjesë 49 delegatë që përfaqësonin të gjitha viset dhe shtresat shoqërore të Kosovës. Midis pjesëmarrësve kishte komunistë, nacionalistë dhe atdhetarë të tjerë demokratë, përfaqësues të Forcave të Armatosura, të rinisë e të gruas antifashiste etj.

Në këtë konferencë morën pjesë 49 delegatë që përfaqësonin popullin e Kosovës dhe forcat politike të rreshtuara të Frontit Antifashist Nacional-çlirimtar të Kosovës. Konferenca shqyrtoi tri ditë radhazi problemet që dilnin nga lufta kundër pushtuesit. Ajo zgjodhi kryesinë prej 9 vetash: Mehmet Hoxha (kryetar) ish-prefekt i Elbasanit, Rifat Berisha (nënkryetar), Pavle Joviqeviçin



(nënkryetar), Xheladin Hana (anëtar), Fadil Hoxha (anëtar), Hajdar Dushi (anëtar), Zekeria Rexha (anëtar), Milan Zečarin (anëtar) dhe Ali Shukriun (anëtar)

Konferenca e Bujanit doli me një dokument përfundimtar, me rezolutë të miratuar në konferencë, ku thuhet: "Kosova dhe Rrafshi i Dukagjinit është krahinë e banuar me shumicë nga populli shqiptar, i cili, si gjithmonë,

ashtu edhe sot, dëshiron me u bashkuar me Shqipërinë". Formulimi i një qëndrimi të tillë, siç thoshte Hajdar Dushi, mbështetej në vetë deklaratat e PKJ-së dhe të KANÇ-it të Jugosllavisë, në të cilat njihej parimi i vetëvendosjes së popujve deri në shkëputje, parim bazë ky i Kartës së Atlantikut, i shpallur solemnisht nga aleatët e koalicionit antifashist.

Më poshtë në rezolutë theksohej se

"Lufta e përbashkët me popujt e tjerë të Jugosllavisë kundër okupatorit nazist e rrogëtarëve të tij, është e vetmja rrugë për ta fituar lirinë, në të cilën të gjithë popujt, pra edhe populli shqiptar, do të kenë mundësi me vetëvendosë mbi fatin e tyre, me të drejtën e vetëvendosjes deri në shkëputje. Garant për këtë është UNÇ i Jugosllavisë dhe UNÇSH i Shqipërisë, me të cilën është ngushtësisht e lidhur. Përveç këtyre, për këtë garan-

tojnë aleatët tanë të mëdhenj, Bashkimi Sovjetik, Anglia e Amerika (Karta e Atlantikut, Konferenca e Moskës dhe e Teheranit)".

Kosova dhe Rrafshi i Dukagjinit është një anë, e cila popullohet në pjesën më të madhe nga popullsia shqiptare, e cila, si gjithmonë, dëshiron edhe sot të bashkohet me Shqipërinë. Prandaj, e ndiejmë për detyrë ta vëmë në dukje rrugën e vërtetë në të cilën duhet të ecë populli shqiptar për të realizuar aspiratat e veta. Rruga e vetme për t'u bashkuar me Shqipërinë, për shqiptarët e Kosovës dhe të Rrafshit të Dukagjinit, është lufta e përbashkët me popujt e tjerë të Jugosllavisë.

Në vitin 1946 Tito ka deklaruar për agjencinë amerikane "Associated Press" se "Kosova dhe territore të tjera shqiptare do t'i kthehen Shqipërisë". Udhëheqësi i ish-Jugosllavisë, Josip Broz Tito i ka premtuar Enver Hoxhës, në vitin 1946, se do t'i kthente Kosovën dhe territore të tjera shqiptare që ndodheshin në bashkimin jugosllav. Gazeta serbe "Pravda" shkruan se Tito në vitin 1946 për pak sa nuk i ka "dhuruar" Hoxhës Kosovën dhe Metohinë, por edhe territore të tjera shqiptare. Pak e njohur është për botën, ku ish-udhëheqësi jugosllav kishte thënë hapur se: "Kosova dhe territore të tjera me shumicë shqiptare do t'i kthehen Shqipërisë".





Artistët e Ansambilit Barok, pjesë e Orkestrës së Forcave të Armatosura, çuan magjishëm tingujt e muzikës më të zgjedhur shqiptare dhe botërore në qytetin e serenatave. Atmosferë fantastike, nën interpretimin e djemve dhe vajzave të FA-së, në këto ditë festash!

